
BULETINI INFORMATIV

Mars 2025

AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË



**Buletin mujor i aktiviteteve të Akademisë së
Shkencave të Shqipërisë**

Mars, 2025

Përmbajtje

Projekti madhor “Enciklopedia shqiptare”	6
U zhvillua mbledhja e redaksisë vendore për projektin madhor “Enciklopedia shqiptare”	7
U zhvilluan takimet e anëtarëve të redaksisë vendore e redaktorëve përgjegjës për projektin madhor “Enciklopedia shqiptare”	11
U zhvilluan takimet e anëtarëve të redaksisë vendore e redaktorëve përgjegjës për projektin madhor “Enciklopedia shqiptare”	14
U zhvillua mbledhja e redaksive vendore Kosovë-Shqipëri për fazën përfundimtare të projektit madhor të “Enciklopedisë shqiptare” në Vërmicë të Kosovës	18
Projekti madhor “Historia e shqiptarëve”	20
U zhvillua mbledhja e Redaksisë Qendrore të projektit madhor “Historia e shqiptarëve”	21
U zhvillua mbledhja e redaksisë qendrore të projektit madhor “Historia e shqiptarëve”	23
Projekti madhor “Fjalor i madh i gjuhës shqipe”	26
Takim i grupeve të punës për realizimin e projektit "Fjalor i madh i gjuhës shqipe" në Kosovë.....	27
Mbledhje të komisioneve të përhershme të ASHSH	28
U zhvillua mbledhja e Komisionit të Mjekësisë.....	29
U zhvillua mbledhja e Komisionit të fizikë-kimisë	33
Mbledhje të bordit të drejtorëve.....	36
U mbajt mbledhja e bordit të drejtorëve dhe drejtuesve të instituteve e qendrave kërkimore shkencore për disa ndryshime për zbatimin e ndarjes së buxhetit për vitin 2025.....	37

Marrëveshje bashkëpunimi	39
Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi”, Agjencia Telegrafike Shqiptare dhe Qendra e Studimit të Arteve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi në fushën e historisë së fotografisë shqiptare	40
Marrëveshje bashkëpunimi midis Akademisë së Shkencave dhe Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore	42
U nënshkrua një memorandum mirëkuptimi ndërmjet Institutit të Arkeologjisë, pjesë e ASHSH-së, dhe Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim për ngritjen e Qendrës Multifunktionale në Parkun Arkeologjik të Bylisit	44
Mbledhje me kryeredaktorët e revistave	48
U zhvillua takimi me kryeredaktorët e revistave të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë	49
Aktivitete	52
Akademia e Shkencave e Shqipërisë zhvilloi veprimtarinë shkencore jubilarë kushtuar poetit akademik Xhevahir Spahiu në 80-vjetorin e lindjes.....	53
Konstituohet Njësia e kërkimeve gjeografike pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë	60
U zhvillua workshop-i shkencor me temën “Aktivizimi i potencialit shqiptar për të formësuar të ardhmen e ujit”	64
Akademikë e studiues të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë morën pjesë në konferencën shkencore ndërkombëtare: “100 vjet nga Republika Parlamentare Shqiptare (1925-2025)”	67
U organizua simpoziumi “Shkenca e hapur”	72
U zhvillua konferenca shkencore “Ndryshimet klimatike dhe uji: mbyllja e hendekut të paralajmërimit të hershëm së bashku”	75
Takimi i projektit “Slow Memory” Cost Action CA20105 në Tiranë	79
U zhvillua konferenca “Viti arkeologjik 2024”	82
Vizitë zyrtare e delegacionit kinez të Aleancës së Organizatave Ndërkombëtare të Shkencës (ANSO) në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.....	85

Njësia NanoAlb, pjesë e Akademisë së Shkencave, zhvilloi veprimtarinë “Ditë të hapura për kërkimin në grupet NanoBALKAN”	89
Jubile akademik	91
Akademia e Shkencave uron akademikun e asociuar Stefan Çapaliku në ditën e tij të lindjes	92
Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Kryesia e saj i urojnë kirurgut të njohur akademik Besim Elezit: Gëzuar 90 vjetorin e lindjes!	93
Botime të reja	97
Botimet më të fundit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë	98

Projekti madhor “Enciklopedia shqiptare”

U zhvillua mbledhja e redaksisë vendore për projektin madhor “Enciklopedia shqiptare”



Më 10 mars 2025, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, u zhvillua mbledhja e redaksisë vendore Tiranë, që kishte si objekt raportimin nga koordinatorët për ecurinë e punës dhe përfundimin e fazës së dorëzimit të fjalësit të njësuar të projektit madhor “Enciklopedia shqiptare”.

Në takim morën pjesë kryeredaktori për “Enciklopedinë shqiptare” akad. Skënder Gjinushi, kryetar i Akademisë së Shkencave; sekretarja shkencore e Akademisë së Shkencave akad. Anila Hoda; drejtori i Qendrës së Studimeve Enciklopedike dhe Albanologjike (QBEA) dr. Arian Leka; drejtuesi i redaksisë vendore Tiranë dhe përgjegjës i sektorit të Enciklopedisë shqiptare akad. Shaban Sinani; akad. Kosta Bajraba; akad. Ilirjan Malollari; akad. Anastas Angjeli; akad. Adem Bunguri; prof. Perikli Qiriazi; prof. Aleksandër Xhuvani, si dhe anëtarë të redaksisë vendore e koordinatorë të fushave.

Takimi u hap nga akad. Skënder Gjinushi. Ai theksoi se dorëzimi i fjalësve të njësuar prej 27 redaksive të fushave të projektit “Enciklopedia shqiptare”, përfshi edhe integrimin e propozimeve të redaksisë së posaçme të Republikës së Maqedonisë së

Veriut, shënon përfundimin e njëres prej fazave më të rëndësishme të punës. Me dorëzimin e fjalësit të unifikuar vërehet se kanë marrë zgjidhje pjesa më e qenësishme e problematikave për një fjalës të përbashkët të njësuar dhe të stabilizuar, që përbën pasaportën e trashëgimisë kombëtare shqiptare, pa kufij kohorë, gjeopolitikë, kulturorë, dialektorë dhe fetarë. Ai theksoi se u është dhënë zgjidhje edhe pjesës më të madhe të çështjeve të diskutuara në takimet e Vërmicës (tetor, 2024) dhe të raportuara nga takimet mes redaksive të grupfushave (korrik- dhjetor 2024) dhe redaksive të fushave (janar-mars 2025).



Me përfundimin e këtij procesi i hapet rruga bashkimit paraprak të lëndës enciklopedike në një amzë të përgjithshme të “Enciklopedisë shqiptare”, të alfabetizuar, të numerizuar dhe të plotësuar me vërejtje, shënime e adresime në shërbim të hapave të mëtejshëm për qëmtime teknike e përmbajtësore në vijim të procesit.

Drejtuesi i redaksisë vendore akad. Sinani dha një informacion për gjendjen e fjalësve të fushave të trashëgimisë kulturore, arteve skenike, pamore dhe multimediale, ngulimeve historike dhe diasporës, të religjioneve dhe komunikimit e mjeteve të komunikimit. Ai theksoi se janë dorëzuar fjalësit e bashkuar e të unifikuar nga të gjitha redaksitë dhe është siguruar panorama për lëndën enciklopedike, e cila paraqitet më e plotë dhe ofron informacion të shumanshëm. Me zgjidhjen e detyrës së dorëzimit të fjalësve në këtë formë garantohet që Enciklopedia shqiptare nuk do të jetë një bashkim formal trashëgimish, por pamje integrale e saj.

Drejtori i Qendrës së Botimeve Enciklopedike dr. Arian Leka, pasi dha një informacion për gjendjen e fjalësve të fushave të letërsisë dhe gjuhësisë, vlerësoi bashkimin e prurjeve enciklopedike në një amzë të përbashkët. Ai tha se ky bashkim po shmang në pjesën sunduese përsëritjet e vëna re më herët, duke bërë të mundur që artikulli enciklopedik të shfaqet vetëm një herë dhe te fusha më përfaqësuese, duke bërë njëkohësisht shmangien e dubleteve konceptuale dhe përfshirjen e disa zërave të veçantë në zëra më përmbledhës.

Dr. Leka theksoi se elementi i pavarësimit të “Enciklopedisë shqiptare” nga prurjet e mëhershme të karakterit enciklopedik (FESH, FEK) është ruajtur. Kemi të bëjmë me lëndë dhe qasje të re, pasi artikujt e propozuar të ESH-së janë kryesisht terma të rinj apo të rishikuar rrënjësisht, krahasuar me FESH-in dhe FEK-un. Të dhënat e pasqyruara në dy tabelat e statistikuar që kanë si qëllim të orientojnë prurjet për njësitë enciklopedike, gjithsej 12 880 artikuj, dëshmojnë gjithashtu edhe zbatimin e njërit prej kriterëve themelore në hartimin e kësaj enciklopedie, siç është ai i përfaqësimit kryesisht përmes termave të përgjithshëm, e jo përmes termave të përveçëm, personaliteteve, siç është në natyrë të fjalorëve enciklopedikë të botimeve paraardhëse.

Në vijim, anëtarja e redaksisë vendore Tiranë akad. Anila Hoda dha një informacion për gjendjen e fjalësit të njësuar të fushave të bujqësisë dhe blegtorisë, mjekësisë dhe mjedisit.

Akad. Ilirjan Malollari dha një informacion për gjendjen e fjalësit të njësuar të fushave të shkencave të natyrës: matematikë-fizikë, kimi-biologji, gjeologji-miniera dhe industrinë e teknologjitë.

Akad. Anastas Angjeli dha një informacion për gjendjen e fjalësit të njësuar të fushave të ekonomisë dhe financës.

Akademik Kosta Barjaba dha një informacion për gjendjen e fjalësit të njësuar të fushave të shkencave shoqërore, sporteve, sistemeve politike e drejtësisë.

Akad. Adem Bunguri dha një informacion për gjendjen e fjalësit të njësuar të fushave të arkeologjisë; lashtësia, mesjeta, bizanti, periudha osmane dhe rilindja, histori e shek. XX, historia ushtarake (Lufta II botërore).

Prof. Perikli Qirjazi dha një informacion për gjendjen e fjalësit të njësuar të fushave të gjeografisë fizike dhe sociale.

Prof. dr. Aleksandër Xhuvani dha një informacion për gjendjen e fjalësit të njësuar të fushave të energjisë dhe energjetikës, industrisë dhe teknologjisë.

Më tej vijuan diskutimet për ecurinë dhe problematikat e hasura në redaksitë e fushave që koordinojnë, që do t'i paraprijnë takimit dypalësh të redaksive vendore Tiranë-Prishtinë gjatë muajit mars 2025.

Disa nga problematikat e vërejtura në takim që kërkojnë zgjidhje ishin: titullimi i disa njësive, sidomos nga redaksi të fushave shoqërore dhe albanologjike. Në disa raste

vazhdon të mbetet me strukturë fjalie, periudhe, fraze. Karakteri proliks shkakton përhumbjen e fjalës-çelës që identifikon njësinë. Disa titullime, të cilat përmbajnë që në krye qëndrim paralajmërues, mund të merren nga lexuesi si qëndrim subjektiv i njëanshëm. Kjo ndodh kur titulli përmban në formën e vet fillestare një epitete.

Një tjetër problematikë është çështja formale e shkrimit, ku nuk është përfillur rekomandimi i redaksisë qendrore, që emërtimet e përveçme në këtë fushë të mos shenjohen me rend të ndërsjellë, si emrat e personaliteteve, por me strukturë togfjalëshi.

Gjithashtu, paraqesin probleme rastet e ndarjes së të njëjtës njësi në disa pjesë jo për shkak të ndryshimit të brendshëm të tyre, por thjesht për shkak të periodizimit të përgjithshëm të historisë etj. Ka dhe ndonjë rast ku nuk janë përfshirë në tërësinë e tyre propozimet e redaksisë së posaçme të ngritur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

www.akad.gov.al

U zhvilluan takimet e anëtarëve të redaksisë vendore e redaktorëve përgjegjës për projektin madhor “Enciklopedia shqiptare”



Më 17 mars 2025 u zhvilluan dy takime me anëtarët e redaksisë vendore e redaktorët përgjegjës për projektin madhor “Enciklopedia shqiptare” të Qendrës së Studimeve Enciklopedike dhe Albanologjike, pjesë e ASHSH-së.

Mbledhja e parë u drejtua nga kryeredaktori i “Enciklopedisë shqiptare” akad. Skënder Gjinushi, kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, dhe drejtori i Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike dr. Arian Leka.

Morën pjesë redaktorët përgjegjës të redaksisë vendore të fushave: arsimimi, trashëgimia kulturore; artet skenike pamore dhe multimediale; ngulimet historike dhe diaspora; religjionet; komunikimi. Këto fusha u përfaqësuan përkatësisht nga akad. Shaban Sinani, drejtuesi i redaksisë vendore dhe përgjegjës i seksionit për Enciklopedinë shqiptare; prof. dr. Josif Papagjoni; Naim Zoto; prof. dr. Afërdita Onuzi, dr. Geron Kamberi, prof. asoc. dr. Albert Nikolla.

Kryeredaktori i “Enciklopedisë shqiptare”, akad. Gjinushi, falënderoi redaktorët përgjegjës dhe vlerësoi punën e bërë nga anëtarët e redaksisë vendore për koordinimin me redaksitë, duke theksuar se me fjalësin e njëzuar të të gjitha fushave, kemi një panoramë më të plotë mbi lëndën enciklopedike. Ai tha se fjalësi është njëzuar dhe pas

përfundimit të punës, raportet e përfaqësimit midis trashëgimisë në Shqipëri, Kosovë e në pjesë të tjera të hapësirës historike-kulturore shqiptare janë respektuar. Në vëmendje për këto redaksi duhet mbajtur edhe çështja e karakterit formal e teknik, që disa nga njësitë themelore të shkruhen në rend të drejtë dhe të shmangen përfundimisht mbivendosjet. Tashmë puna në vijim mbetet tek mënyra e kategorizimit dhe e paraqitjes së artikujve në “Enciklopedinë shqiptare”. Akad. Gjinushi theksoi se qëllimi i këtij takimi është parapërgatitja për mbledhjen mes redaksive vendore Shqipëri-Kosovë, që do të mbahet më 25-26 mars 2025, në Vërmicë (Prizren).



Redaktorët e fushave diskutuan për prekjën e disa zërave, të cilat janë hequr me konsensus me redaksitë përgjegjëse të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut dhe për koordinimin e tyre. U diskutua gjithashtu edhe veçimi i zërave sipas rëndësisë, si dhe ruajtja e kriterëve të njëjta e të barazlanguara në listat e përfshirjes së personaliteteve në ESH.

Pas përfundimit të takimit me redaksitë e fushave të sipërmendura u zhvillua takimi me anëtarët e redaksisë vendore e redaktorët përgjegjës të fushave: energjitë dhe energjetika; industrinë dhe teknologjinë, ku ishin të pranishëm redaktorët përgjegjës, përkatësisht prof. dr. Aleksandër Xhuvani, akad. Rajmonda Buhaljoti dhe prof.dr. Andrea Maliqari.

Akad. Buhaljoti raportoi se është koordinuar me redaksitë e Kosovës e Maqedonisë për veçimin e zërave, harmonizimin e fjalësit të bashkuar. Ajo tha se puna

me zërat ka përfunduar dhe është plotësuar lista e personaliteteve sipas kriterëve të dakordësuar, duke këshilluar Udhëzuesin praktik.



Gjithashtu dr. Aleksandër Xhuvani dhe prof. dr. Andrea Maliqari raportuan për përfundimin e punës me artikujt, respektimin e caqeve të njësive enciklopedike, riadresimet e fundit lidhur me emërtimet që nuk i takojnë redaksisë, por shkojnë te fusha dominante, spikatjen më të madhe të disa personaliteteve me kontribute të rëndësishëm mësimdhënien universitare, të cilët kanë rol në fushat e energjetikës e teknologjisë, duke i vlerësuar ata brenda kriterit, por edhe në mbështetje të cilësive të veçanta profesionale e shkencore, si themelues katedrash, hartues tekstesh etj.

Në përfundim të takimeve, kryeredaktori akad. Gjinushi dha disa rekomandime të nevojshme për punën e mëtejshme me konceptimin e fjalësit të përbashkët, të njësuar e të stabilizuar, si dhe plotësimin me argumente mbështetëse për disa nga artikujt e propozuar, për të cilët njohja është ende e kufizuar.

www.akad.gov.al

U zhvilluan takimet e anëtarëve të redaksisë vendore e redaktorëve përgjegjës për projektin madhor “Enciklopedia shqiptare”



Më 18 mars 2025 u zhvilluan tri takime me anëtarët e redaksisë vendore e redaktorët përgjegjës për projektin madhor “Enciklopedia shqiptare” të Qendrës së Studimeve Enciklopedike dhe Albanologjike, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Në takim morën pjesë redaktorët përgjegjës të redaksisë vendore të fushave përkatëse bujqësia dhe blegtoaria; mjekësia dhe mjedisi; arkeologjia dhe lashtësia, mesjeta e Bizanti, periudha osmane dhe Rilindja, histori e shek. XX, historia ushtarake; gjeografi fizike e gjeografi sociale: akad. Anila Hoda, sekretare shkencore e Akademisë së Shkencave, prof. dr. Vjollca Ibro, akad. emeritus Nestor Thereska, dr. Arber Pecani, prof. dr. Seit Shallari; akad. Adem Bunguri, akad. asoc. Gëzim Hoxha, akad. Pëllumb Xhufi, akad. Beqir Meta, prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi, prof. dr. Perikli Qiriazi, prof. dr. Skënder Sala, prof. dr. Dhimitër Doka.

Mbledhja e parë u drejtua nga kryeredaktori i “Enciklopedisë shqiptare” akad. Skënder Gjinushi, kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, dhe drejtori i Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike dr. Arian Leka.

Akad. Gjinushi falënderoi anëtarët e redaksisë vendore e redaktorët përgjegjës për punën e mirë që është bërë në hartimin e fjalësit dhe koordinimin e zërave me redaksitë e Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, duke konstatuar punën cilësore për zgjedhjen dhe stabilizimin e listave të tyre sipas kërkesave. Më tej, ai vuri në dukje se ky

takim bëhet për disa shqetësime dhe çështje ende në diskutim dhe zbatim të detyrave të lëna në takimet e mëparshme. Një nga arsyet e takimit është konsolidimi i kriterëve të njëjta e të baraslarguara në përzgjedhje, veçanërisht për termat e përveçëm, që përbëjnë listat e përfshirjes së personaliteteve në “Enciklopedinë shqiptare”.

Akad. Anila Hoda, në rolin e anëtares së redaksisë vendore dhe koordinatorit të grupredaksive, moderoi takimin e redaksisë së mjekësisë, bujqësisë dhe mjedisit. Ajo theksoi se puna për hartimin dhe finalizimin e fjalësit enciklopedik ka vijuar në bashkëpunim me kolegët nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, duke e çuar procesin e punës me fjalësit në një fazë të re dhe më të lartë. Procesi ka përfshirë takime të rregullta, diskutime e vërejtje konstruktive, si dhe një vëmendje të detajuar për ta pasuruar dhe përmirësuar përmbajtjen e “Enciklopedisë shqiptare” me lëndë të re, që nuk gjendet në botimet enciklopedike paraardhëse FESH dhe FEK. Fjalësit e paraqitur janë të përbashkët dhe të dakordësuar. Është arritur gjithashtu edhe përfshirja e stabilizimi i artikujve enciklopedikë (AE) të fushës së pyjeve, e personaliteteve të fushave të veterinarisë dhe pyjeve, si dhe bashkëpunimi me redaksitë e tjera (mjedisi, biologjia, gjeografia, ekonomia) për shmangien e mungesave dhe përsëritjeve në artikujt e propozuar të ESH-së.



Gjatë diskutimeve prof. dr. Vjollca Ibro pohoi se janë adresuar problemet për numrin e zërave, për të cilët është komunikuar me institucionet për verifikime, dhe për

harmonizimin e fjalësit të bashkuar.

Akad. emeritus Thereska, në fund të diskutimeve, pohoi se është bërë një punë e mirë edhe me ekipin e Maqedonisë dhe Kosovës, me të cilët kjo redaksi ka pasur mirëkuptim të plotë për artikujt e propozuar.

Pas përfundimit të takimit me redaksitë e fushave të sipërmendura u zhvillua takimi me anëtarët e redaksisë vendore e redaktorët përgjegjës të fushave: arkeologji dhe lashtësi, mesjeta e Bizantit, periudha osmane dhe Rilindja, histori e shek. XX, historia ushtarake.

Akad. Adem Bunguri, në pozicionin e anëtarit të redaksisë vendore dhe koordinаторit të grupredaksive pohoi se pas shumë diskutimeve e takimeve me anëtarët e redaksisë vendore dhe ata të Kosovës e Maqedonisë, janë harmonizuar termat në bashkëpunim me redaksitë e tyre dhe si rezultat është arritur edhe një fjalës i përbashkët, me përjashtim të disa rasteve kur historia i trajton ndryshe dukuritë dhe ngjarjet.



Akad. Hoxha, si drejtues i redaksisë së lashtësisë u shpreh se është bërë një punë konstruktive e detajuar për të përmirësuar përmbajtjen e “Enciklopedisë shqiptare” dhe mbeten për t’u shqyrtuar çështje formale të shkrimit apo riadresimet e fundit mes kësaj redaksie dhe redaksive të religjionit dhe trashëgimisë.

Akad. Xhufi diskutoi për saktësimin e emrave të personaliteteve historike dhe harmonizimin e termave që janë përfshirë në Enciklopedinë shqiptare.

Drejtori i QBEA-së në kuadër të këtyre diskutimeve, theksoi se me dorëzimin e listave prej të gjitha redaksive është bërë e qartë se kemi të bëjmë me një vepër unike dhe se kjo lëndë enciklopedike shtron kërkesën e bashkimit në një amzë të përgjithshme të Enciklopedisë shqiptare gjatë muajve në vijim. Ai foli gjithashtu për punën dhe përpjekjet e vijueshme që janë bërë gjatë takimeve të shumta me redaksitë e fushave dhe grupfushave nga dhjetori 2024 deri në mars 2025, duke ndjekur me vëmendje të veçantë vlerësimin e kriterëve dhe përpjekjet për respektimin e udhëzuesit praktik.

Takimi i tretë me redaksinë e fushës gjeografi fizike e gjeografi sociale u moderua nga drejtori i QBEA-së, dr. Leka. Ai vlerësoi punën e fushës së gjeografisë dhe gjithë redaktorëve të “Enciklopedisë shqiptare”, por theksoi vërejtjen se emërtimet e përveçme të kësaj redaksie janë shprehur me rend të ndërsjelltë. Falë përpjekjeve të vazhdueshme është arritur të unifikohen artikujt për të gjithë hapësirën shqiptare. Ato do të rrinë veç vetëm në rastet kur historia i trajton ndryshe. Ai shfaqti kërkesën që listat për personalitetet të dërgohen nëpër redaksitë me synimin që të që të tregohet arsyeja e përfshirjes dhe të mos krijohen zëra artificiale.

Prof. dr. Perikli Qiriaz, prof. Skënder Sala dhe prof. dr. Dhimitër Doka diskutuan më tej për spikatjen e zërave për zonat e mbrojtura dhe parqet. Është pasur kujdes që të koordinohen me gjeografinë dhe të veçohen sipas rëndësisë.

Kryeredaktori i ESH-së, akad. Gjinushi, la detyrë që redaksia qendrore të garantojë zbatimin e kriterëve dhe theksoi se diskutimet do të vlejné si parapërgatitje për mbledhjen mes redaksive vendore Shqipëri-Kosovë, që do të mbahet më 25-26 mars 2025, në Vërmicë (Prizren).

Në fund të këtij takimi u konkludua se redaksitë janë të gatshme për fazën përfundimtare të përpunimit dhe publikimit të “Enciklopedisë shqiptare”.

www.akad.gov.al

U zhvillua mbledhja e redaksive vendore Kosovë-Shqipëri për fazën përfundimtare të projektit madhor të “Enciklopedisë shqiptare” në Vërmicë të Kosovës



Në datat 25-26 mars 2025 në Vërmicë (Prizren) të Kosovës u zhvillua mbledhja e dy redaksive vendore për fazën përfundimtare të shqyrtimit e miratimit të fjalësit të projektit madhor “Enciklopedia shqiptare” (ESH).

Kjo mbledhje u zhvillua pas përfundimit të punës prej 27 redaksive të fushave (më 20 shkurt 2025) për hartimin e fjalësve të përbashkët dhe të unifikuar për çdo fushë.

Deri më 19 mars 2025 redaksitë vendore në Tiranë dhe Prishtinë kryen shqyrtime mbi këtë fjalës, me objekt pune verifikimin e zbatimit të kriterëve të njëjta në përzgjedhjen e zërave.

Takimin e Vërmicës e drejtuan kryeredaktori i “Enciklopedisë shqiptare” akad. Skënder Gjinushi, kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, dhe zëvendëskryeredaktori akad. Mehmet Kraja, kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Gjatë takimit dyditor të redaksive vendore u bënë sugjerimet, vërejtjet e propozimet e fundit mbi listat e 20 shkurtit 2025 me qëllim paraqitjen për shqyrtim të mëtejshëm prej redaksisë qendrore.

Në fund, të dyja redaksitë, pasi vlerësuan në tërësi punën e redaksive të fushave, mbështetur mbi raportin e paraqitur nga QBEA-ja për realizimin e respektimin në

përgjithësi të kriterëve e të detyrave të vëna nga redaksitë vendore e koordinatorët mbi vlerësimin e anëtarëve se fjalësi plotësonte pritshmërinë si nga ana cilësore e nga madhësia në rreth 12 000 artikuj, miratuan në parim fjalësin e përbashkët të redaksive të fushave.



Redaksitë vendore përcaktuan detyra për vijimin e procesit të punës me “Enciklopedinë shqiptare” për përgatitjen e fjalësve, për t’ia kaluar redaksisë qendrore për miratim përfundimtar. Në ndihmë të tyre e për të përcjellë sa më qartë rekomandimet, përmirësimet e kërkesat e formuluar gjatë takimit QBEA-ja u ngarkua për t’i përmbledhur ato. Para paraqitjes për miratim të fjalësit enciklopedik prej redaksisë qendrore, redaksitë e fushave duhet ndër të tjera të stabilizojnë fjalësin përfundimtar të dakordësuar, të rregullojnë emërtimin e zërave kur është e nevojshme, të evidentojnë dublimet kur është e mundur, të reflektojnë përmirësimet e kërkuara e veçanërisht të pasurojnë fjalësin me argumentin kryesor për plotësimin e kriterëve prej zërit përkatës, kur shihet e nevojshme e sidomos për ngjarje a individë të veçantë e për mbajtësit e titullit profesor etj.

Pas miratimit të fjalësit nga redaksia qendrore parashikohet që deri në qershor të këtij viti bëhet kategorizimi i zërave e të përcaktohen autorët e shkrimit të tyre për të kaluar kështu në fazën e hartimit të “Enciklopedisë shqiptare”.

www.akad.gov.al

Projekti madhor “Historia e shqiptarëve”

U zhvillua mbledhja e Redaksisë Qendrore të projektit madhor “Historia e shqiptarëve”



Më 7 mars 2025 Qendra e Botimeve Enciklopedike Albanologjike (QBEA) organizoi mbledhjen e Redaksisë Qendrore të projektit madhor “Historia e shqiptarëve”.

Në këtë takim pune përveç anëtarëve të kësaj redaksie akad. Pëllumb Xhufi, prof. Paskal Milo, prof. Ferit Duka, prof. Neritan Ceka mori pjesë dhe drejtori i QBEA-së dr. Arian Leka.

Qëllimi i kësaj mbledhjeje ishte shqyrtimi i mëtejshëm dhe përfundimtar nga redaksia qendrore i dy volumeve të para “Lashtësia” dhe “Mesjeta”, para se ato t’i nënshtrohen recensionimit.

Fillimisht drejtori i Qendrës bëri një përshkrim lidhur me ecurinë e punës dhe gjendjen aktuale të dy vëllimeve të para të projektit madhor “Historia e shqiptarëve”.

Dr. Leka informoi anëtarët e redaksisë qendrore mbi hapat që do të ndiqen lidhur me procesin fundor të redaktimit shkencor dhe proceset e tjera redaksionale-drejtshtkrimore dhe stilistike.

Anëtarët e Redaksisë Qendrore vijuan më tej me diskutimet mbi çështje të përmbajtjes së dy veprave. Gjatë analizimit të vëllimit I - “Lashtësia” me 699 faqe dhe vëllimit II - “Mesjeta” me 722 faqe, prof. Paskal Milo dhe prof. Ferit Duka konstatuan se lënda shkencore e paraqitur sjell qasje të reja në përmbajtje, trajtime të pasuruara të temave ekzistuese e plotësime të tematikave të munguara, duke përmbushur kriteret

shkencore të synuara. Veprat dëshmojnë fazat e qytetërimit shqiptar sipas periudhave, duke mbuluar në mënyrë tërësore hapësirën e banuar nga shqiptarët gjatë gjithë historisë së tyre të lashtë dhe mesjetës.



U vërejt gjithashtu se të dyja vëllimet ndalen në momentet historike kryesore, shtjellojnë figurat më të spikatura dhe ndriçojnë ngjarjet madhore, duke bërë evidentimin e plotë formave të zhvillimit historik, organizimit social, politik e kulturor të shqiptarëve në territoret e banuara prej tyre.

U nënvizua gjithashtu edhe fakti se veprat kanë ndjekur metodologji bashkëkohore të historiografisë, duke sjellë risi përballë teksteve me tematikë të ngjashme botuar më herët. Gjatë takimit, redaktorëve përgjegjës të periudhave akad. Pëllumb Xhufit dhe prof. Neritan Cekës iu bënë sugjerime lidhur me një organizim më të arrirë të lëndës, si dhe u theksua kërkesa për avancim të punës në lidhje me proceset editoriale.

Takimi i radhës së kësaj redaksie, që përmbyll këtë fazë pune do të zhvillohet më 20 mars 2025.

www.akad.gov.al

U zhvillua mbledhja e redaksisë qendrore të projektit madhor “Historia e shqiptarëve”



Më 20 mars 2025 Qendra e Botimeve Enciklopedike Albanologjike (QBEA) organizoi mbledhjen e redaksisë qendrore të projektit madhor “Historia e shqiptarëve” për shqyrtimin e dy vëllimeve të para “Lashtësia” dhe “Mesjeta”.

Në takim morën pjesë anëtarët e redaksisë qendrore akad. Pëllumb Xhufi, prof. dr. Neritan Ceka, prof. dr. Paskal Milo, prof. dr. Ferit Duka dhe drejtori i Qendrës së botimeve Enciklopedike e Albanologjike (QBEA) dr. Arian Leka.

Në fjalën e tij drejtori i QBEA-së bëri një përshkrim të ecurisë së punës gjatë procesit të organizimit të veprës, duke theksuar se të dyja vëllimet ndriçojnë momentet historike kryesore, figurat më të spikatura dhe ngjarjet madhore. Është bërë një punë e mirë për evidentimin e periudhave historike, të organizimit social, politik e kulturor të shqiptarëve në territoret e banuara prej tyre, në rritjen e cilësisë e shkrimit të materialit shkencor dhe në forcimin e argumentimin e plotë të tezave për trashëgiminë iliro-arbërore.

Akad. Pëllumb Xhufi foli për përmirësimet që duhen bërë në përcaktimin e saktë të emërimit të periudhave historike dhe shmangien e tezave të pasigurta. Ai vlerësoi punën e bërë në vëllimin “Lashtësia”, ku theksoi se është bërë një trajtim i mirë i periudhave historike dhe në përcjelljen e njohurive arkeologjike në linjën e argumenteve historike.



Anëtarët e tjerë të redaksisë qendrore vijuan me diskutime për përmirësimet e disa zërave në përmbajtjen e dy veprave.

Prof. dr. Milo diskutoi për saktësimin e autorëve dhe shmangien e mbivendosjeve e saktësimin e citimeve.

Anëtarët e redaksisë diskutuan së bashku për saktësimin e disa burimeve historike, termave historike të para në këndvështrimin e koherencës së ngjarjeve, si dhe për një përkujdesje të veçantë për saktësimin e titujve për periudhat e përfshira në të dyja veprat.

Prof. dr. Ceka bëri vlerësime për shkrimin e historisë së mesjetës. Ai tha se materialet janë të punuara mirë nga autorët. Nga anëtarët e redaksisë u diskutua për një përkujdesje të veçantë nëse është e nevojshme apo jo që të shkurtohen tekste. Gjithashtu u diskutua edhe për respektimin e periodizimit të lashtësisë dhe mesjetës.

Prof. dr. Ferid Duka tha se është bërë një punë e jashtëzakonshme në hartimin e dy vëllimeve të veprës “Historia e shqiptarëve”. Ai shprehu përgëzimet e tij për autorët e veprës akad. Pëllumb Xhufin dhe prof. dr. Cekën dhe dha disa ide për përmirësimin e pasqyrës së lëndës dhe për një koordinim sa më të mirë të fazave historike, nga një autor tek tjetri.

Gjithashtu, edhe prof. dr. Paskal Milo vlerësoi cilësinë e shkrimit të dy vëllimeve dhe shprehu idetë e tij për shkurtrimin e disa referencave në rast se kanë mbivendosje.

Në mbyllje të kësaj mbledhjeje, anëtarët e redaksisë miratuan në konsensus të plotë propozimet për redaktimet përfundimtare të dy vëllimeve të para të “Historisë së

shqiptarëve”, “Lashtësia” dhe “Mesjeta”.



www.akad.gov.al

Projekti madhor “Fjalor i madh i gjuhës shqipe”

Takim i grupeve të punës për realizimin e projektit "Fjalori i madh i gjuhës shqipe" në Kosovë

Në datën 20 mars 2025 u mbajt takimi i radhës i grupit hartues të projektit "Fjalori i madh i gjuhës shqipe" në Institutin Albanologjik në Prishtinë, Kosovë. Nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë morën pjesë akad. Valter Memishaj, sekretar shkencor dhe bashkëdrejtues i "Fjalorit të madh të gjuhës shqipe"; prof. asoc. dr. Anila Kananaj, koordinatore dhe redaktore shkencore dhe Engjëllushe Karaj, redaktore gjuhësore-letrare dhe hartuese. Nga Instituti Albanologjik i Prishtinës ishin të pranishëm prof. dr. Shefkije Islamaj, drejtuese e grupit të punës në Prishtinë dhe anëtare e redaksisë së Fjalorit, njëkohësisht hartuese; prof. asoc. dr. Naim Berisha, hartues dhe ushtrues detyre i drejtorit të Institutit Albanologjik; prof. asoc. dr. Abdurrahim Maxhuni, hartues dhe shef i degës së gjuhësisë në IAP-it, si dhe prof. asoc. dr. Sejdi M. Gashi, hartues.

Përfaqësuesit nga Akademia e Shkencave përgëzuan z. Berisha për punën e mirë dhe ritmin e ri të sjellë në Institutin Albanologjik dhe premtuan mbështetje të pakursyer për projektet shkencore të këtij institucioni.

Grupi hartues diskutoi gjerësisht për procesin aktual, duke u fokusuar te mbyllja e hartimit dhe redaktimit të materialit, si dhe te sistematizimi dhe unifikimi i paraqitjes leksikografike. U theksua gjithashtu se vepra mbetet e hapur për pasurimin e mëtejshëm të lëndës me fjalë, kuptime dhe thënie ilustruese nga secili hartues. Gjatë këtij takimi u konstatua se "Fjalori i Madh i Gjuhës Shqipe" ka hyrë në fazën përfundimtare, ku gjatë vitit 2025 po punohet intensivisht.

"Fjalori i Madh i Gjuhës Shqipe" është projekt i rëndësishëm mbarëkombëtar, i cili po realizohet nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë në bashkëpunim edhe me Institutin Albanologjik-Prishtinë. Fjalori do të përfshijë rreth 120.000 zëra leksikografikë, ku përfshihen edhe mbi 11.000 njësi frazeologjike.

Mbledhje të komisioneve të përhershme të ASHSH

U zhvillua mbledhja e Komisionit të Mjekësisë



Më 12 mars 2025 u zhvillua mbledhja e Komisionit të mjekësisë, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Në mbledhje morën pjesë akad. emeritus Nestor Thereska; akad. Genc Sulçebe; prof. Albana Fico; prof. Anila Godo; prof. Xheladin Dracini; prof. asoc. Erda Qorri; prof. asoc. Arbi Pecani; prof. Arjan Harxhi dhe akad. Anesti Kondili (online).

Tematika e kësaj veprimtarie u ideua dhe moderua nga prof. Arjan Harxhi (Komisioni i mjekësisë, ASHSH), me synimin për të përcaktuar rëndësinë e provave klinike në mjekësi, gjendjen aktuale dhe perspektivat e zhvillimeve në këtë fushë.

Mbledhja u hap nga kryetari i Komisionit të mjekësisë akad. Genc Sulçebe, i cili pasi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në këtë veprimtari, theksoi se paraqitja e temave të këtij takimi dhe pasqyrimi i tyre në media shërben dhe si një kampanë për njohjen dhe trajtimin e këtyre problematikave nga vendimmarrësit e sistemit shëndetësor.

Më pas pjesëmarrësit prezantuan studimet e tyre për gjendjen aktuale dhe perspektivat e zhvillimeve në fushën e mjekësisë.

Kërkuesi klinik dr. Arian Pano (konsulent kryesor i GeorgeP LLC, USA (Biofarmaceutikë R&D) foli kryesisht për zhvillimet e kërkimit shkencor në fushën e mjekësisë dhe dha disa udhëzime nga përvoja e tij disavjeçare në SHBA. Dr. Pano vuri në dukje se Shqipëria ka zhvillime të mëdha në fushën e shëndetësisë, e cila është në përmirësim të vazhdueshëm dhe ka krijuar kapacitete për të mbështetur kërkimin klinik. Integrimi në BE do t'i hapë dyert Shqipërisë për të stimuluar dhe promovuar

kërkimin klinik si në drejtim të financimit, ashtu dhe të legjislacionit. Shqipëria ka potencialin që në hapësirën 5-10 vjeçare të arrijë drejt një qendre kërkimore mbështetëse, respektivisht me 50 -100 prova klinike në vit, të konsiderueshme këto si nga ana shkencore dhe ajo financiare. Përfitimi i shqiptarëve dhe i gjithë sistemit shëndetësor është aksesimi në trajtimin mjekësor të një niveli të lartë, frenimi i "ikjes së trurit" dhe një mori përfitimesh të tjera. Për këto arsye, duhet të fillojë planifikimi dhe krijimi i strukturave dhe politikave për të stimuluar dhe promovuar kërkimet klinike në Shqipëri.

Dr. Bledi Pine, bashkëpunëtor i kërkimit klinik (CRA) foli për etikën dhe rregullat për implementimin e studimeve klinike në vendin tonë. Ai theksoi se përpara se të fillojë një studim klinik, ai duhet të miratohet nga një komitet etik i specializuar për të vlerësuar rreziqet dhe përfitimet që mund të sjellin studimet për pjesëmarrësit në to.



Prof. Leonard Deda (Komiteti Kombëtar i Etikës) paraqiti një studim për problematikat e implementimit të studimeve klinike në Shqipëri, parë në perspektivën e komitetit të etikës. Ai e vuri theksin tek zbatimi i rregullores së provave klinike, e cila harmonizon proceset për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e tyre në të gjithë BE-në. Sponsorët e provave klinike duhet të dorëzojnë aplikime veçmas tek autoritetet kompetente kombëtare dhe komitetet e etikës në çdo vend, për të marrë miratimin për

të kryer një provë klinike. Rregullorja u mundëson që të paraqesin një aplikim në internet, nëpërmjet një platforme të vetme online, të njohur si Sistemi i Informacionit të Provave Klinike (CTIS) për të kryer një provë klinike në disa vende europiane, duke e bërë më të arritshme kryerjen e provave shumëkombëshe. Qëllimi është të nxitet inovacioni dhe kërkimi në BE, duke lehtësuar kryerjen e provave klinike më të mëdha në shumë shtete anëtare të BE-së.



Prof. Arjan Harxhi referoi për disa problematika të implementimit të studimeve klinike në Shqipëri, si: miratimi i provës klinike nëpërmjet aplikimit pranë organeve rregullatore të quajtura Autoriteti Rregullator (kompetent); shqyrtimi i protokollit dhe dhënia e një opinioni pozitiv ose negativ nga Komiteti i Etikës së Kërkimit (REC); implementimi i studimeve klinike në Shqipëri për barnat në përputhje me ligjin, rregulloret, direktivat dhe udhëzimet.

Standardi përcaktohet nga Këshilli Ndërkombëtar për Harmonizimin e Kërkesave Teknike për Barnat për Përdorim në Njerëz (ICH-GCP). Ky standard duhet të zbatohet në të gjitha shtetet anëtare të BE-së dhe përshkruan përgjegjësitë dhe pritshmëritë e të gjithë pjesëmarrësve në kryerjen e provave klinike, duke përfshirë investiguesit, monitoruesit, sponsorët dhe komitetet e etikës.

Më tej, prof. Harxhi i njohu të pranishmit me ligjet e nenet përkatëse për provat klinike në mjekësi, ku përfshihen hetimet klinike të pajisjeve mjekësore, dhënia e

autorizimit të tregtimit të barnave e të klasifikimit të tyre në Republikën e Shqipërisë etj. Ai u shpreh se Shqipëria ka një potencial shëndetësor në përmirësim të vazhdueshëm të kujdesit shëndetësor dhe qasjes në mjekim, duke krijuar kështu një kapacitet të fortë për të mbështetur kërkimin klinik.

Akad. Nestor Thereska vlerësoi faktin që relacioni i këtij takimi me pikat kryesore të studimeve do të paraqitet në kryesinë e Akademisë së Shkencave dhe më pas dhe në Ministrinë e Shëndetësisë. Ai tha se studime dhe raporte të tilla duhet të dërgohen dhe të bëhen të ditura dhe nga vendimmarrësit e sistemit shëndetësor.

Në fund, prof. Alban Ylli shprehu bindjen për kapërcimin e pengesave ligjore dhe financiare për provat klinike, që të fillohet e të bëhet planifikimi dhe krijimi i strukturave dhe politikave për të stimuluar dhe promovuar kërkimet klinike në Shqipëri.

www.akad.gov.al

U zhvillua mbledhja e Komisionit të fizikë-kimisë



Në datën 26 mars 2025 u zhvillua mbledhja e Komisionit të fizikë-kimisë.

Në takim morën pjesë akad. emeritus Florian Vila, akad. asoc Besnik Baraj, akad. Neki Frashëri (online), akad. Mimoza Hafizi (online), prof. dr. Rozana Troja, prof.dr. Petrit Zorba, prof. dr. Elida Bylyku, prof. dr. Partizan Malkaj, prof. dr. Fatos Ylli, prof. dr. Elda Marku, prof. asoc. Shaniko Allajbeu, prof. asoc. Klaudio Peqini, prof. dr. Spiro Drushku, prof. asoc. Florian Mandija (online).

Mbledhja u hap nga kryetari i Komisionit akad. emeritus Florian Vila, i cili paraqiti programin e punës së Njesisë së kërkim-studimit “Pasuritë ujore” dhe kërkesën për zgjatjen e afatit të saj për periudhën 2-vjeçare.

Akad. asoc. Besnik Baraj, drejtuesi i Njesisë së kërkim-studimit “Pasuritë ujore”, foli për objektivat e vëna në periudhën e parë maj 2023 – dhjetor 2024, të cilat kishin si qëllim mbështetjen dhe intensifikimin e menaxhimit të qëndrueshëm dhe të integruar të ujërave në vend. Puna e njesisë u fokusua në tri drejtime: së pari, evidentimi i problematikës që ekziston në sektorin e ujërave; së dyti, njohja e forcimi i kapaciteteve të grupeve shkencore në institucionet e arsimit të lartë dhe së treti, krijimi i platformës së dialogut ndërmjet përfaqësuesve të komunitetit shkencor dhe institucioneve administrative e politikbërësve. Më tej, ai paraqiti planifikimin e veprimtarive dhe projekteve për vitin 2025 dhe planifikimin e përafërt për vitin 2026.

Në këtë takim u diskutua për masat ndërmarra për organizimin e aktiviteteve të propozuara për 6- mujorin e parë të 2025-s.



Akad. emeritus Vila paraqiti aktivitetet e Institutit Kombëtar të Fizikës (IKF) për 6- mujorin e parë të 2025-s, ku theksin e vuri në organizimin e Konferencës së tretë shkencore që do të mbahet në datat 2-3 qershor 2025, në vijim të traditës së krijuar prej disa vitesh. Qëllimi i kësaj konference është mbështetja e shpërndarjes së rezultateve të kërkimit shkencor në sfondin e arritjeve më të fundit në fizikë, përfshirë këtu dhe mësimdhënien; konsolidimin e rrjetit të bashkëpunimit mes fizikanëve shqiptarë e joshqiptarë si dhe zgjerimin i IKF-së me anëtarë të rinj. Duke qenë se 2025-a është shpallur Viti Ndërkombëtar i Teknologjisë Kuantike, konferenca synon gjithashtu të ketë në fokusin e saj arritjet madhore në këtë fushë të zhvillimit të fizikës.

Prof. dr. Rozana Troja, në emër të grupit të punës të ngritur nga komisioni, paraqiti përgatitjet që po bëhen për forumin e planifikuar në datën 28 maj 2025 lidhur me studimet e ciklit të tretë (doktoratura për fizikë dhe kimi) në institucionet e arsimit të lartë, si dhe disa nga arritjet dhe problematikat.

Kjo përfaqëse ndaj këtij problemi madhor në studimet pasuniversitare bëhet edhe në vijim të detyrimit ligjor për akreditimin e programeve të studimit të ciklit të tretë.

Në pikën e fundit të rendit të ditës u trajtuan çështjet themelore të njësive të kërkim- studimit në programet e tyre të punës.

Akad. Vila propozoi që në përfundim të projekteve është e nevojshme të planifikohet konferencë, simpozium apo forum, ku të diskutohet për arritjet dhe aplikimet e projektit, si dhe për t'ua bërë të njohura rezultatet e tij përdoruesve të mundshëm.

Prof. dr. Petrit Zorba shprehu mendimin për organizimin e një veprimtarie në fushën e meteorologjisë dhe ndikimeve klimaterike.

Të gjithë anëtarët e komisionit shprehën dakordësinë për organizimin e një veprimtarie me rastin e 100- vjetorit të fluturimit të parë ajror në Shqipëri, në lidhje me fenomenet e meteorologjisë dhe aviacionit.

www.akad.gov.al

Mbledhje të bordit të drejtorëve

U mbajt mbledhja e bordit të drejtorëve dhe drejtuesve të instituteve e qendrave kërkimore shkencore për disa ndryshime për zbatimin e ndarjes së buxhetit për vitin 2025



Më 17 mars 2025 u mbajt mbledhja e bordit të drejtorëve, e përbërë nga drejtuesit e instituteve dhe qendrave kërkimore shkencore, kryetarët e komisioneve të përhershme pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Mbledhjen e drejtoi Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi.

Në pikën e parë e të dytë të rendit të ditës u bë diskutimi e miratimi në parim i udhëzimit për kryerjen e shpenzimeve, si dhe u miratuan disa ndryshime në nënzërat e buxhetit për vitin 2025 për disa institute dhe qendra kërkimore në bazë të kërkesave të njësive të paraqitura nga kancelari.

Në mbledhje u theksua se për zbatimin e buxhetit përgjegjësinë e kompetencën e kanë drejtuesit e njësive për buxhetin e tyre. U ngarkua kancelari për riformulimin e udhëzimit të ri në bazë të vërejtjeve të bëra në mënyrë që marrëdhëniet e njësive me administratën të jenë sa më qarta e në përputhje me rregullat.

Në pikën e tretë të rendit të ditës u bë njohja me raportin përfundimtar të auditit të performancës me temë: “Projektet kërkimore shkencore të realizuara nga ASHSH në nxitjen e përparimit shkencor, teknologjik, dhe inovacionit për të mirën e vendit” të KLSH-së dhe draft përgjigjet mbi këtë raport prej njësive dhe bordit të drejtorëve, ku në esencë konkludohet se gjetjet nuk qëndrojnë e nuk reflektojnë realitetin e se për pasojë rekomandimet janë ose pa vend ose të tejkaluara. Nga mbledhja doli se në fakt nuk

është kryer as formalisht një audit performance të njësive e projekteve të realizuara nga ato.



Në fund u diskutua për botimet e revistave dhe pas diskutimeve u la një takim tjetër me grupin e ngushtë të botuesve për të parë e organizuar vijueshmërinë e pasqyrimin të tyre online me qëllim rritjen e shikueshmërisë e te indeksimit të tyre.

www.akad.gov.al

Marrëveshje bashkëpunimi

Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi”, Agjencia Telegrafike Shqiptare dhe Qendra e Studimit të Arteve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi në fushën e historisë së fotografisë shqiptare




Më 5 mars 2025 u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi në fushën e historisë së fotografisë shqiptare mes Muzeut Kombëtar të Fotografisë “Marubi”, Agjencisë Telegrafike Shqiptare dhe Qendrës së Studimit të Arteve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Marrëveshja u nënshkrua në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë nga drejtuesit e këtyre institucioneve, përkatësisht dr. Luçjan Bedeni, znj. Valbona Zhupa dhe akad. asoc. Stefan Çapaliku.

Marrëveshja konsiston në realizimin e projektit shkencor “Antologjia e fotografisë shqiptare”, e iniciuar nga Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi”, me synim që të promovojë trashëgiminë fotografike shqiptare.

Drejtori i Qendrës së Studimit të Arteve, akad. asoc. Stefan Çapaliku çeli ceremoninë duke shprehur kënaqësinë për bashkëpunimin në përpilimin e kësaj antologjie të parë retrospektive të fotografisë shqiptare. Ai tha se fotografia, fatkeqësisht, nuk ka qenë në fokus të studimeve të QSA-së.

Arkivi më i madh i fotografisë shqiptare gjendet në Muzeun “Marubi” në Shkodër, por edhe pranë ATSH-së ka një arkiv mjaft të pasur të fotografisë. Me këto dy burime dhe të tjera të ndërsjella që do të vijnë nga kërkimet tona si Qendër e Studimit të Arteve, do të mund t’ia dalim që brenda një kohe dyvjeçare të kemi këtë vepër shumë të rëndësishme.



Drejtori i Muzeut “Marubi”, dr. Bedeni, e vlerësoi bashkëpunimin mes palëve dhe u shpreh se pas arkivit të “Marubit”, arkivi më i rëndësishëm është ai i ATSH-së, që dokumenton kryesisht historinë e realizimit socialist shqiptar.

Drejtoresha e përgjithshme e ATSH-së, znj. Valbona Zhupa, tha se, ndonëse kjo antologji është e vonuar, do të risjellë në kujtesë emrat e fotografëve, si dhe dëshminë e punës së tyre të çmuar.

Ajo u shpreh më tej se Agjencia Telegrafike Shqiptare është agjencia e vetme zyrtare në vend, që daton nga viti 1912. Arkivi i saj është jashtëzakonisht i pasur, me mbi 260 mijë fotografi dhe negativë, të cilat aktualisht janë në proces digjitalizimi.

Znj. Zhupa e vuri theksin edhe te kontributi i institucionit që ajo drejton, në përgatitjen e këtij botimi të veçantë për promovimin e studimit të fotografisë, si një narrativë e plotë dhe autentike për brezat e sotëm dhe ata që do të vijnë.

Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, në kuadër të realizimit të projektit shkencor “Antologjia e fotografisë shqiptare”, do të organizohen vizita dhe takime në institucione të cilat kanë si pasuri arkiva fotografikë, ku do të mund të hulumtohen imazhet e përshtatshme për botimin. Në vijim të punës do të planifikohen takime të përbashkëta për të diskutuar strukturën që do të ketë botimi dhe përmbajtja e tij. Gjithashtu, takime të hapura për publikun do të organizohen bashkërisht me qëllim që të njihet dhe promovohet botimi.

www.akad.gov.al

Marrëveshje bashkëpunimi midis Akademisë së Shkencave dhe Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore



Sot më 10 mars 2025 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi nga kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi dhe drejtoresha e përgjithshme e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, znj. Anila Shehu.

Përpara nënshkrimit të marrëveshjes, kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë bëri një prezantim të funksionimit të qendrave dhe njësisve shkencore të ASHSH-së dhe shtrirjes së bashkëpunimeve të këtyre qendrave në rajon dhe në qendra të rëndësishme të kërkimit shkencor në Europë e më gjerë.

Ai shprehu mbështetjen dhe interesin që ka ASSHSH-ja si institucioni më i lartë i kërkimit shkencor në vend për bashkëpunime të institucionalizuara.

Më tej, akad. Gjinushi e vuri theksin në rolin e Akademisë së Shkencave për të këshilluar e ndihmuar qeverinë dhe institucionet qendrore me rekomandime, ekspertiza e opinionca për aspekte të rëndësishme të kërkimit shkencor, të formimit të specialistëve të lartë dhe të planifikimit të projekteve të së ardhmes për të përmbushur edhe angazhimet në kuadër të integritimit në BE.



Drejtoresha e përgjithshme e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, znj. Anila Shehu, falënderoi Akademinë e Shkencave, duke evidentuar faktin se kjo marrëveshje do të krijojë mundësinë që në projekte që AMBU-ja zhvillon në fokusin e gjeoinxhinierisë e gjeoshkencave, në fushën e pasurisë ujore, të bashkëpunojë me specialistët e Akademisë së Shkencave në fushën e ekspertizave. Ajo vuri në dukje rolin e specialistëve për ekspertizën në përpilimin dhe zbatimin e rezultateve. Znj. Shehu tha më tej se Shqipëria ka ekspertë shumë të mirë dhe synimi është që ata të përfshihen më gjerësisht në projektet europiane.

Akad. Gjinushi premtoi se ASHSH-ja do të nxisë bashkëpunimin e njësive dhe qendrave të kërkim studimit pranë saj me AMBU-në, siç janë njësia e gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive e njësia e pasurive ujore.

Në takimin për nënshkrimin e marrëveshjes ishin të pranishëm zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave akad. Vasil Tole; sekretarja shkencore akad. Anila Hoda; kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike akad. Neki Frashëri; drejtuesi i njësisë së gjeoinxhinierisë dhe gjeoshkencave, akad. asoc. Rrapo Ormeni; z. Dion Jemini, përgjegjës sektori (AMBU) etj.

Marrëveshja e nënshkruar ka si synim zhvillimin e veprimtarive me interes të përbashkët, lidhur me kërkimin shkencor, projektet, ekspertizat dhe oponencat tekniko-ligjore në fushën e gjeoinxhinierisë dhe gjeoshkencave, pasurive ujore dhe mjedisit.

www.akad.gov.al

U nënshkrua një memorandum mirëkuptimi ndërmjet Institutit të Arkeologjisë, pjesë e ASHSH-së, dhe Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim për ngritjen e Qendrës Multifunkionale në Parkun Arkeologjik të Bylisit



Sot, më 12 mars 2025, në ambientet e Institutit Arkeologjik në Tiranë u nënshkrua një memorandum mirëkuptimi ndërmjet Institutit të Arkeologjisë (IA), pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, dhe Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim (AICS) për planin e konservimit të objekteve të zbuluara dhe projektin e ngritjes së Qendrës Multifunkionale në Parkun Arkeologjik të Bylisit, ku përfshihen qytetet antike Bylis dhe Klos.

Në hapje të ceremonisë së rastit, kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi shprehu kënaqësinë që në ambientet e Institutit Arkeologjik firmoset një memorandum bashkëpunimi për sitet arkeologjike.

Kryetari i Akademisë së Shkencave falënderoi me këtë rast Bashkimin Europian për mbështetjen dhe për investimet edhe në drejtim të zhvillimit të kërkimit shkencor në Shqipëri dhe veçanërisht për investimet për pasqyrimin e trashëgimisë kulturore të vendit tonë. Gjithashtu ai shprehu kënaqësinë që pas negociatave të vazhdueshme, një projekt kaq i rëndësishëm, siç është kthimi i Bylisit në një qendër multifunkionale, do

të bëhet me kooperacionin italian.



Akad. Gjinushi theksoi se kjo është një marrëveshje model, për të cilën vetë Instituti i Arkeologjisë dhe punonjësit e tij janë më se të interesuar, sepse pritet që puna e tyre shumëvjeçare të jetë sa më e aksesueshme dhe e ekspozuar ndaj publikut të gjerë. Si rrjedhojë, realizimi i projektit në bashkëpunim me Institutin e Arkeologjisë për pjesën shkencore është mënyra më e mirë për të rivlerësuar dhe pasqyruar gjerësisht trashëgiminë tonë. Siti arkeologjik i Bylisit është një nga sitet kryesore, krahas atyre më të njohura të vendit, si Butrinti e Apolonia. Kështu që në zbatim të kësaj marrëveshjeje Bylisi do zërë vendin që i takon, duke shërbyer si pikë referimi për studime, kërkime dhe për promovimin e trashëgimisë sonë arkeologjike.

Akad. Gjinushi u shpreh më tej se pas realizimit të projektit për muzeun qendror të Bylisit, Akademia e Shkencave e Shqipërisë do të mirëpresë edhe bashkëpunime të tjera në të ardhmen, me perspektivën për t'i dhënë dimensionet e duhura edhe Muzeut Arkeologjik pranë Institutit Arkeologjik, pjesë e ASHSH-së, këtu në Tiranë.

Drejtoresha e Zyrës Rajonale të AICS-së, znj. Stefania Vizzaccaro, shprehu entuziazëm për memorandum, të cilin e vlerësoi si një hap thelbësor për realizimin e projektit të ngritjes së Qendrës Multifunkionale në Parkun Arkeologjik të Bylisit. Ajo tha se projekti në thelb synon zhvillimin ekonomik vendor drejtuar nga turizmi, por që gjithmonë përqendrohet tek trashëgimia kulturore.



Drejtoresha e Zyrës Rajonale të AICS-së njoftoi të pranishmit se projekti do të realizohet me fondet e BE-së, të cilat arrijnë shifrën 6.15 milionë euro.

Ajo falënderoi kryesinë e Akademisë së Shkencave për bashkëpunimin dhe veçanërisht kryetarin e ASHSH-së akad. Skënder Gjinushi, zv.kryetarin akad. Vasil Tole, si dhe akad. Adem Bungurin e akad. asoc. Gëzim Hoxhën për punën e çmuar në bashkëpunimin për konsultimin e projekteve të konservimit dhe të hartimit të strategjive për Qendrën Multifunktionale të Bylisit. Me këtë rast, ajo vlerësoi kontributin për dekada me radhë të punës kërkimore të Institutit Arkeologjik që ka krijuar një trashëgimi të pasur njohurish e praktikash të suksesshme e ekspertizash shkencore, të cilat do të kontribuojnë në mënyrë ekskluzive në këtë projekt.

Më pas u bë nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit përkatësisht nga drejtoresha e Zyrës Rajonale të AICS-së znj. Stefania Vizzaccaro dhe akad. Adem Bunguri, drejtori i Institutit Arkeologjik, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Ky memorandum ka si objekt vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit tekniko-shkencor mes palëve, në kuadër të realizimit të projektit të BE-së për Parkun Arkeologjik Bylis dhe Klos, orientuar nga turizmi me fokus trashëgiminë kulturore. Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim do të bashkëpunojë dhe koordinojë informacionin, arkivin dhe asistencën teknike në veprimtaritë në terren, të cilat i shërbejnë AICS-së dhe nënkontraktorëve apo partnerëve si ndihmë për hartimin e projekteve në respekt të të drejtave të autorëve që kanë zhvilluar veprimtarinë

arkeologjike në Bylis.



Pas nënshkrimit të memorandumit u zhvillua një vizitë në muzeun dhe fondin arkivor të Institutit Arkeologjik.

www.akad.gov.al

Mbledhje me kryeredaktorët e revistave

U zhvillua takimi me kryeredaktorët e revistave të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë



Më 10 mars 2025 u zhvillua takimi i punës me kryeredaktorët e revistave të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Takimi u drejtua nga Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi.

Morën pjesë: akad. Anila Hodo, sekretare shkencore e ASHSH-së; akad. Neki Frashëri, kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike dhe kryeredaktor i revistës "JNTS"; akad. asoc. Gëzim Hoxha, kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike dhe kryeredaktor i revistës "Studia Albanica"; akad. Adem Bunguri, drejtor i Institutit të Arkeologjisë dhe kryeredaktor i revistës "Iliria"; akad. Valter Memisha, drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë dhe kryeredaktor i revistës "Studime filologjike"; prof. dr. Hamit Kaba, drejtor i Institutit të Historisë dhe kryeredaktor i revistës "Studime historike"; akad. Marenglen Verli, kryeredaktor i revistës "Albanian studies"; prof. dr. Anila Omari; prof. asoc. dr. Gjon Boriçi, dr. Albana Velianj, përgjegjëse e bibliotekës së ASHSH-së; dr. Mikaela Minga, kryeredaktore e revistës "Antropologjia", Mirlona Buzo, drejtore e QKIPSH-së; dr. Jonida Gashi, kryeredaktore e revistës "Studime për artin".

Qëllimi i takimit ishte vijimi i punës dhe marrja e masave për standardizimin dhe indeksimin e të gjitha revistave shkencore të Akademisë së Shkencave në platformat më të njohura ndërkombëtare.

Takimi nisi me parashtrimin e çështjeve për diskutim sipas rendit të mbledhjes. Në fjalën e tij, kryetari akad. Gjinushi theksoi se duhen ndërmarrë hapa për t'i përfshirë

të gjitha revistat në një platformë të përbashkët online të ASHSH-së, realizimi i procedurave për të pajisur të gjithë periodikët me eISSN dhe me logon përkatëse të ASHSH-së. Ai u ndal në përpjekjet që duhen bërë nga kryeredaktorët dhe bordet editoriale për përmirësimin dhe rritjen e standardeve e cilësisë së materialeve shkencore që do të botohen në revistat e ASHSH-së. Domosdoshmërinë për të zhvilluar politika më të mira editoriale dhe rishikim të anëtarëve të bordeve editoriale të revistave.



Ndër çështjet e parashtruara për diskutim ishte përcaktimi dhe respektimi i periodicitetit në botimin e revistave, përfshirja e sa më shumë autorëve të huaj dhe të diasporës për të publikuar artikuj në revistat e ASHSH-së, si dhe një politikë konkurruese dhe hapëse.

Kryetari i Akademisë së Shkencave u la detyrë kryeredaktorëve për nxitjen e vazhdueshme të studiuesve që të botojnë rezultatet e kërkimeve shkencore në revistat e ASHSH-së dhe të bëhet menjëherë përcaktimi korrekt i adresës së autorëve. U theksua se korrektësia e adresës së autorëve duhet të zbatohet në të gjitha botimet e revistave të ASHSH-së: “Studime historike”, “Albanian studies”, “Studime për artin”, “Studia Albanica”, “Candavia”, “Iliria”, “Antropologjia”, “JNTS”, “Studime filologjike”, përfshirë dhe ato jashtë revistave të ASHSH-së.

Në fjalën e saj, sekretarja shkencore akad. Anila Hoda trajtoi çështjen e përditësimit të rregullave të botimit në revistat e ASHSH-së. Bazuar në standardet e revistave më prestigjioze, ajo dha udhëzimet konkrete mbi udhërrëfyesit për publikim për autorët, marrjen e masave për evitimin e konfliktit të interesit, formular standard

për punën e recensentëve dhe për krijimin e një modeli tip për artikujt shkencorë, që do të ndiqen hap pas hapi për botimin e artikujve në revistat shkencore.




Në fund të diskutimeve dhe detyrat e lëna për zgjidhje u vendos krijimi i grupit të punës, i përbërë nga akad. Anila Hoda, sekretare shkencore e Akademisë së Shkencave; akad. Neki Frashëri, dr. Mikaela Minga, dr. Jonida Gashi, prof. asoc. dr Gjon Boriçi, Mirlona Buzo dhe Marsela Meta.

www.akad.gov.al

Aktivitete

**Akademia e Shkencave e Shqipërisë zhvilloi veprimtarinë shkencore jubilarë
kushtuar poetit akademik Xhevahir Spahiu në 80-vjetorin e lindjes**



Më 4 mars 2025 Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, zhvilluan veprimtarinë shkencore jubilarë "Xhevahir Spahiu në 80-vjetorin e lindjes".

Kjo veprimtari u zhvillua me praninë e kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi, zëvendëskryetarit të ASHSH-së akad. Vasil Tole, sekretares shkencore të ASHSH-së akad. Anila Hoda, kryetarëve të seksioneve të ASHSH-së, studiuesve dhe kritikut të letërsisë akad. Ali Aliut (Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës), prof. dr. Eqrem Bashës (ASHAK), drejtuesve të instituteve dhe qendrave shkencore të ASHSH-së etj., si dhe miqve e familjarëve të poetit akademik Xhevahir Spahiu.

Akad. Gëzim Hoxha, kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, mbajti një fjalë përshëndetëse në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Pasi shprehu urimet për 80-vjetorin e akad. Xhevahir Spahiut,

ai vuri në dukje vlerat më të spikatura të tij si poet dhe akademik, i cili përbën një aset të veçantë për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.



Akad. Hoxha theksoi se ky vit, përveç datëlindjes jubilarë, shënon mbi gjysmë shekulli të krijimtarisë letrare poetike të Xhevahir Spahiut. Ai krijoi një individualitet emblematic duke shkruar për kompleksitetin e historisë shqiptare, të kulturës dhe identitetit të saj, me rrënjët nga lashtësia e deri në aktualitetin e trazuar, gjithmonë duke iu referuar temës së lirisë dhe përpjekjes për të mbrojtur njerëzoren dhe të bukurën. Zëri i tij poetik mbetet dëshmi e fuqisë krijuese, që beson te forca e fjalës, beson në shpirtin e një kombi, por edhe tek ajo që e bashkon këtë komb me universalen e njerëzimit. Më tej ai foli për rezonancën e veprës së akad. Spahiut në letërsinë botërore dhe veçoi disa nga vlerësimet më thelbësore të kritikës.

Akad. Hoxha ia dha fjalën akad. Ali Aliut, studiuesit dhe kritikut të njohur të letërsisë. Akad. Aliu tha se Xhevahir Spahiu është poet në 24 orët e ditës. Ai ka një ndjesi të madhe për gjuhën dhe në këtë pikë qëndron mbi të gjithë poetët. Xhevahir Spahiu e konsideron fjalën si diçka të gjallë e të shenjtë. Ai ka lënë një gjurmë të veçantë në letërsinë shqipe, që njihet si fjala dhe vargu i Xhevahirit.

“Xhevahir Spahiu është Lorika i poezisë shqipe”, -tha në fund të fjalës së tij përshëndetëse akad. Ali Aliu.

Më pas ceremoninë e përshëndeti kryetari i shoqatës “Tomorri” z. Nuri Çuni, i cili i dorëzoi një dekoratë nga Kryegjyshi Botëror Bektashian, Baba Mondit, në shenjë

mirënjohjeje për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme për bektashizmin dhe për poezinë e tij të mrekullueshme për Malin e Tomorrit dhe trevat rreth tij.



Veprimtaria vijoi më tej me 4 kumtesa akademike për veprën e akad. Spahiut.

Studiuesi dhe kritiku i letërsisë prof. dr. Bashkim Kuçuku mbajti kumtesën me temën “Koha e patejkalueshme e poezisë”. Ai e vlerësoi fillimisht poetin për rebelizmin e tij si poet e qytetar në vitet më të vështira për letërsinë shqipe, ‘70-’90, i cili e ka të mishëruar lirinë të fjala. Ai e cilësoi Xhevahir Spahiun si një poet me një shprehje të fuqishme metaforike, që ka sjellë risi në poezi dhe ka ngritur një sistem metaforash, të cilat në stilistikën e letërsisë shqipe konsiderohen si një megaforë e hapur, e vijueshme dhe koherente. E plotësuar nga vëllimi në vëllim, dukshëm, e dallueshme nga megaforat dhe megasimbolikët e autorëve të tjerë bashkëkohës, ajo përbëhet nga konstante motivesh figurative të përsëritshme, të cilat, duke u riaktivizuar dhe rishpërfaqur në kontekste të ndryshme, pasurojnë radhazi kuptime dhe domethëniet e tyre. Në kumtesën e tij, prof. dr. Kuçuku solli shembuj nga zbulesat stilistike, shoqëruar me vargje të zgjedhura të poetit.

Prof. asoc. dr. Viola Isufaj mbajti kumtesën me temën “Vetëdija letrare e Xhevahir Spahiut përkundrejt shformimeve të metodës socrealiste”. Ajo theksoi se Xhevahir Spahiu ka hyrë në poezinë shqipe me energji tërësisht individuale, me sinqeritet siu generis dhe kreativitet. Udhën po ia çelte një intuitë e fortë poetike, me të cilën do të vinte jo vetëm për të marrë vendin e tij në poezinë shqipe, por edhe për ta

pasuruar madje, deri dhe për t'ia ndryshuar larushinë fytyrës së poezisë shqipe. Kjo është një linjë e re e një brezi të rinjsh - me prirje kah modeli europerëndimor i vargëzimit, figuracionit dhe strukturës poetike.



Ajo foli më tej për sfidat e poetit, vështruar në marrëdhënie komplekse me trashëgiminë krijuese, krijimin e një zëri origjinal në letërsinë shqipe me ligjërimin poetik, leksikun, motivet dhe psikologjinë e heroit lirik, dhe më tej me realizmin socialist, ku krijoi një poezi me një ngarkesë të thellë filozofike e letrare.

Dr. Virion Graçi mbajti kumtesën "Nesër jam aty -premtimi i përmbushur i poetit Xhevahir Spahiu". Ai tha se Xhevahiri, i përfshirë ndershmërisht me problematikat shoqërore, me lëvizjet kulturore, u diferencua vetiu nga poetët minorë e pragmatikë; kryelartë, ndoqi yllin e tij të fatit, rrugën e rrezikshme të sinqeritetit, të shqiptimit të unit lirik për t'u madhëruar si poet. Më tej ai nënvizoi disa tipare të profilit poetik të Xhevahir Spahiut, si: retorika e lartë e tribunizmi - jo të lidhura me epikën, me materialen, por retorikë e lartë, duke luajtur me figurat, me përfytyrimet, me simbolet e analogjitë; retorika ngjizet me frymë metafizike, shtron mëdyshje etike, funksionon si përsiatje filozofike; forma grafike e organizimit të ligjërimin poetik, të poezisë, që, thënë ndryshe, i ngjan një orteku ndjenjash, mendimesh, përfytyrimesh tokësore a kozmike, që duhen perceptuar sipas vizionit të krijuesit dhe karakteri polemizues e predikues, të cilin Graçi e përcaktoi si një tipar që spikat në poezitë me tema shoqërore-historike, nga dramat e etnisë dhe kur vizaton me vargje persona të përveçëm, por dhe poezi me fabul nga jeta e përditshme qytetare. Janë shprehje malli, mungesash, keqardhjes, më shumë

sesa çështje të kalueshme, rastësore.



Prof. dr. Aristotel Spiro mbajti kumtesën “Sublimiteti i shprehjes poetike dhe fisnikërimi i gjuhës shqipe”. Ai tha se Xhevahir Spahiu është një nga pikat kulmore të letërsisë shqipe. Krijimtaria e tij, ashtu si te Lasgush Poradeci apo te Kostandin Kavafisi (krahasime që gjithsesi mund të qëndrojnë veç së jashtmi), përbëhet nga poezi më të vogla, të cilat lexohen brenda disa çastesh, por fuqia e përfytyrimit artistik ngulitet në mendje për të mos u fshirë më kurrë. Vepra e tij poetike është një mozaik i bukur i përbërë nga gurë të çmuar vargjesh e poezish, që lexuesit i mbajnë dhe i përdorin duke i bërë pjesë të jetës së tyre të përditshme.

Vargu i Xhevahir Spahiut ka hyrë në ndërgjegjen e shqiptarëve nëpërmjet disa mënyrave. Së pari, nëpërmjet zgjedhjes së lexuesve, të cilët e kanë vlerësuar dhe kërkuar poezinë e tij dhe e kanë bërë pjesë të domosdoshme të bibliotekave të tyre. Së dyti, nëpërmjet përfshirjes në tekstet shkollore, poezia e tij bëhet pjesë e edukimit sistematik të një populli të tërë. Së treti, nëpërmjet këngës së kultivuar e popullore shqiptare. Mjaft poezi të Xhevahir Spahiut kanë shërbyer si lirika për të frymëzuar disa nga këngët më të njohura të traditës muzikore shqiptare, kompozuar nga emra të fuqishëm të muzikës së lehtë. Së katërti, nëpërmjet përkthimit të poezisë së tij në gjuhë të huaja, vargu i Xhevahir Spahiut udhëton nëpër botë, duke përfaqësuar nga njëra anë denjësisht poezinë shqipe, dhe nga ana tjetër duke u bërë pjesë e trashëgimisë poetike

botërore (poezia e tij është përkthyer në gjuhën angleze, frënge, gjermane, spanjolle, italiane, holandeze, maqedonase, turke, ruse, greke, rumune, arabe, japoneze, kineze, kroate, hebraike etj.).



Më tej ai foli për elemente kyçe të stilit letrar të Xhevahir Spahiut, si: muzikaliteti i vargut, integrimi i imazheve të natyrës si mjete të ndërgjegjësimit poetik dhe filozofik, dialogët e ndërlikuar mes individit dhe shoqërisë, disiplina gjuhësore dhe përkushtimi ndaj një poetike të reflektuar e të angazhuar etj.

Veprimtaria vijoi me recitime nga poezitë e zgjedhura të poetit Xhevahir Spahiu, interpretuar nga aktorët Erjona Kakeli dhe Kastriot Ramollari.

Në ceremoninë e 80-vjetorit të poetit u bë edhe një përshëndetje me dy pjesë muzikore me flaut nga instrumentistja Majlinda Spiro. Ajo interpretoi dy vepra, "Les Folies d'Espagne" të Marin Marais-së dhe "Dy skicat" të kompozitorit akad. Vasil Tole, që sjellin motive të muzikës shqiptare në një gjuhë moderne, duke ruajtur energjinë dhe shpirtin e tyre autentik.

Akad. Xhevahir Spahiu shprehu falënderime të përzemërta për Kryesinë e Akademisë së Shkencave, organizatorët dhe të pranishmit për zhvillimin e kësaj ceremonie. Në mbyllje të veprimtarisë, Orgesi, djali i poetit Xhevahir Spahiu, falënderoi të gjithë organizatorët dhe shprehu vlerësimin për të atin poet, shoqëruar me

mirënjohjen që u rrit me praninë dhe frymën e poezive të tij. Ai recitoi disa nga vargjet e përzgjedhura të poetit.

www.akad.gov.al

Konstituohet Njësia e kërkimeve gjeografike pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë



Sot më 5 mars 2025 në Akademinë Shkencave të Shqipërisë u mbajt mbledhja për konstituimin e Njesisë së kërkimeve gjeografike pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Veprimtarinë e çeli gjeografi i njohur prof. dr. Vasil Kristo. Ai u shpreh se është një ditë e shënuar për gjeografët ngritja e Njesisë së kërkimeve gjeografike pranë Akademisë së Shkencave. Ngritja e një njësie si dikur do t'i japë zhvillim shkencës në studimin e gjeografisë së Shqipërisë dhe do të zgjerojë bashkëpunimet që kanë qenë deri në 2007-n midis Qendrës së Studimeve Gjeografike, departamenteve dhe gjeografëve të Kosovës.

Pas fjalës përshëndetëse drejtuesi i Njesisë së kërkimeve gjeografike, prof. dr. Qiriazi falënderoi në mënyrë të veçantë kryetarin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushin për mbështetjen që ka dhënë në ngritjen e kësaj njësie, me dëshirën e madhe për ta kthyer në institut të kërkimeve gjeografike.

Prof. dr. Qiriazi i njohu të pranishmit me vendimin për konstituimin e Njesisë së

kërkimeve gjeografike pranë ASHSH-së. Mbështetur në nenin 4, pika 6 dhe në nenin 19 të ligjit nr.53/2019 "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë dhe në nenin 44 të statutit të saj me nismën dhe kërkesën e një grupi studiuesish të gjeografisë së Shqipërisë, kryesia e ASHSH-së krijoi Njësinë e përkohshme të kërkimeve gjeografike, pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Ai argumentoi më tej domosdoshmërinë e krijimit të njësisë së kërkimeve gjeografike.



Prof. dr. Qiriazi tha se mbyllja e Qendrës së Studimeve Gjeografike në vitin 2007 rezultoi veprim tepër i gabuar. Si rrjedhojë, departamentet e gjeografisë në universitetet e vendit nuk mundën të drejtojnë dhe të realizojnë studime të thelluara dhe përgjithësuese gjeografike në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky problem është bërë më i mprehtë kohët fundit, kur po zvogëlohet vazhdimisht numri i studentëve të degëve të gjeografisë. Më tej, ai foli për vlerat e studimeve gjeografike, ku ndër të tjera theksoi se stadi aktual i zhvillimit përballlet me sfida të mëdha, zgjidhja e të cilave kërkon edhe ndihmesën e studimeve gjeografike, ndër të cilat veçoi humbjen e kapitalit njerëzor për shkak të emigrimit, dëmtimin e ekosistemeve dhe biodiversitetit, që nxisin nevojën urgjente të ekuilibrit midis zhvillimit dhe mbrojtjes së natyrës, si dhe ndërveprimit me shkencat e tjera, si historia, albanologjia etj.

Më pas ai përcakttoi një sërë detyrash të Njësisë së studimeve gjeografike, duke filluar me njohjen dhe promovimin e drejtimeve të metodologjisë dhe metodave të reja të studimeve të sotme gjeografike në botë, sigurimin e mbështetjes dhe oponencës

shkencore për hartimin e artikujve të shumtë gjeografikë të Enciklopedisë shqiptare etj.

Disa nga studimet gjeografike me vlera albanologjike, në të cilat do të fokusohet aktiviteti shkencor i Njesisë janë përditësimi me informacion dhe trajtim të ri të monografisë “Gjeografia fizike”, e para vepër kapitale kolektive e përgatitur dhe botuar rreth 40 vjet më parë nga Qendra e Studimeve Gjeografike.



Më tej ai e vuri theksin te përgatitja dhe drejtimi i disa projekteve, si: “Studimi i vendbanimeve të Shqipërisë e i urbanizmit në vendin tonë dhe ndikimi në ekosistemet vendore e kombëtare”; botimi i monografisë “Qendrat e banuara të Shqipërisë”; “Studimi kompleks regional gjeografik i Shqipërisë”; drejtimi dhe përgatitja e projektit “Popullsia e Shqipërisë”; projekti “Studim i integruar i trashëgimisë natyrore dhe kulturore”; projekti “Studime mbi vlerësimin e potencialeve natyrore dhe humane për zhvillimin vendor e rajonal, si bazë e strategjisë së këtij zhvillimi”; “Shqiptarët në mjedisin e tyre”; “Peizazhi ynë natyror e kulturor gjeografik, degradimi e shkretizimi mi dhe strategjitë e programet e mbrojtjes e vitalizmit të tij”; “Studime për gjeografinë e turizmit të Shqipërisë” etj.

Në vijim të veprimtarisë u prezantua projektregullorja e brendshme për funksionimin e Njesisë, platforma e veprimtarisë shkencore dhe programi i punës për vitin 2025-2026 i përgatitur nga bordi drejtues i kësaj njësie.

Në fund, u bënë diskutime dhe propozime, ku folësit shprehën vlerësimin e tyre për ngjitjen e Njesisë së studimeve gjeografike dhe rëndësinë që ka për t'ua çelur rrugën studimeve të thelluara gjeografike në shërbim të albanologjisë dhe të zgjidhjes së sfidave apo krizave të mëdha me të cilat po përballemi tani ose në të ardhmen.

Njësia kërkimore gjeografike, sipas vendimit të Kryesisë së ASHSH-së, ka një mandat dyvjeçar më të drejtë zgjatjen e këtij mandati edhe dy vite të tjera ose kthimin e saj në institut të kërkimeve gjeografike, në rast se e justifikon këtë me sukseset dhe me studimet e veta shkencore dhe hap perspektivë për të ardhmen.

www.akad.gov.al

U zhvillua workshop-i shkencor me temën “Aktivizimi i potencialit shqiptar për të formësuar të ardhmen e ujit”

Më 12 mars 2025 Njësia e burimeve ujore, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, dhe Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), në kuadër të Ditës Botërore të Ujit organizuan workshop-in shkencor me temën “Aktivizimi i potencialit shqiptar për të formësuar të ardhmen e ujit”.

Kjo veprimtari u zhvillua me pjesëmarrjen e kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi; sekretares shkencore akad. Anila Hoda; anëtarëve të tjerë të kryesisë së ASHSH-së; drejtores së Përgjithshme të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU); përfaqësuesve nga delegacioni i BE-së në Shqipëri, si dhe përfaqësuesve nga zyra rajonale e koordinimit për bashkëpunim teknik, ADA.

Workshop-i shkencor mbledhi së bashku kërkues shqiptarë dhe të huaj të fushës, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe agjencive politikëbërëse dhe zbatuese të lidhura ngushtë me çështjet e ujit, staf akademik të IAL-ve të ndryshme shqiptare, ekspertë, vendimmarrës dhe profesionistë të rinj, me synimin që të prezantojnë kërkimet shkencore dhe të nxisin dialogun shkencor dhe institucional mbi sfidat dhe perspektivat e menaxhimit të qëndrueshëm të ujërave në Shqipëri, në përputhje me direktivën kuadër të BE-së për ujin (DKU).

Sesionin e çeli sekretarja shkencore e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Anila Hoda. Ajo foli për rolin jetik të ujit në zhvillimin ekonomik, stabilitetin social dhe ekuilibrin mjedisor.



Më tej, akad. Hoda nënvizoi angazhimin e Akademisë së Shkencave për të ndërlidhur shkencën dhe vendimmarrjen përmes kërkimit, bashkëpunimit dhe zhvillimit të kapaciteteve, veçanërisht për profesionistët e rinj. Një hap kyç në këtë drejtim është marrëveshja e saponënshkruar midis Akademisë së Shkencave dhe Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), e cila synon të integrojë ekspertizën shkencore në qeverisjen kombëtare të ujërave dhe të forcojë bashkëpunimin institucional.



Takimin e përshëndetën gjithashtu znj. Anila Shehu, drejtore e AMBU-së; z. Jean-Noel Gangloff, oficer programi (Uji, Ekonomia Qarkulluese dhe Mbrojtja Civile), delegacioni i BE-së në Shqipëri, dhe David Muckenhuber, shef i Zyrës Rajonale të Koordinimit për Bashkëpunimin Teknik, Ambasada Austriake, Tiranë.

Referimet u përqendruan në sfidat globale dhe lokale të menaxhimit të ujit, ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe zbatimin e direktivës kuadër të BE-së për ujin.

Prof. Gunter Langergraber (Universiteti BOKU & President, IWA Austria) mbajti një kumtesë mbi perspektivat globale të menaxhimit të qëndrueshëm të ujit.

Prof. Spase Shumka (Universiteti Bujqësor i Tiranës) në kumtesën e tij trajtoi çështjen e ruajtjes së liqeneve të vegjël akullnajorë në Shqipëri.

Xhemi Jaupaj (Universiteti BOKU &) dhe Esmeralda Halo (AMBU) paraqitën studimin për kërkesat e ligjit të ri për ujin dhe nevojën për specialistë të rinj

në sektor.

Prof. Ifigenia Kagalou (Universiteti i Thrakës, Greqi) mbajti një ligjëratë për përvojën greke në zbatimin e direktivës kuadër të BE-së për ujin dhe rolin e shkencës në këtë proces.

Dr. Roza Allabashi (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Njësia e burimeve ujore) paraqiti studimin për rolin e shkencës në transformimin e sektorit të ujit në Shqipëri.

Diskutimet për çështjet e trajtuara në punimet e paraqitura u moderuan nga Alba Zhorri (Projekti EU4Rivers) dhe Xhemi Jaupaj (AMBU).



Gjatë këtyre diskutimeve theksi u vu në përfshirjen e shkencëtarëve të rinj në zhvillimin e politikave për menaxhimin e ujit. Pjesëmarrësit ndanë mendimet e tyre mbi një numër çështjesh në lidhje me rrugët, aftësitë dhe njohuritë interdisiplinore të nevojshme për përfshirjen e profesionistëve të rinj në sektorin e ujit.

U diskutua më tej nevoja për politika të qëndrueshme, roli i shkencës dhe inovacionit në zbatimin e DKU-së, si dhe rëndësia e përfshirjes së profesionistëve të rinj në këtë proces.

Takimi u mbyll me konkluzionet përfundimtare të përfaqësuesve të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe të AMBU-së, të cilët theksuan rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm midis shkencës, politikës dhe praktikës për të arritur një menaxhim të qëndrueshëm të ujërave në Shqipëri.

www.akad.gov.al

Akademikë e studiues të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë morën pjesë në konferencën shkencore ndërkombëtare: “100 vjet nga Republika Parlamentare Shqiptare (1925-2025)”



Në datat 12 - 13 mars 2025 në Universitetin e Elbasanit u zhvillua konferenca shkencore ndërkombëtare me temë “100 vjet nga Republika Parlamentare Shqiptare (1925-2025)”.

Në këtë veprimtari shkencore nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë morën pjesë: akad. emeritus Gjovalin Shkurtaj, akad. Beqir Meta; akad. Marenglen Verli dhe prof.dr. Ledia Dushku.

Akad. emeritus Shkurtaj, në fjalën e tij përshëndetëse për hapjen e konferencës, vuri në dukje etapat kryesore të udhëtimit 100-vjeçar të Republikës Parlamentare.

Akad. Beqir Meta mbajti një kumtesë për tiparet e regjimit republikan nga vitet 1925-1928 në raportet e diplomatëve britanikë.



Akad. Marenglen Verli mbajti një kumtesë për irredentizmin dhe shtetin shqiptar në vitet 1925-1928.



Prof.dr. Ledia Dushku bëri një analizë historike mbi përzgjedhjen e kryeqytetit

gjatë viteve 1912-1925.



Në konferencë morën pjesë edhe përfaqësues të instituteve, pjesë e ASHSH-së, si dr. Jorina Verli, dr. Rovena Vata dhe dr. Erarba Çiraku

Dr. Jorina Verli bëri një pasqyrim të politikave të shtetit shqiptar ndaj kërkesave të fuqive të mëdha për koncesionin në sektorin e naftës.



Dr. Rovena Vata bëri një paraqitje të trazimeve të qershorit të vitit 1924 në penën publicistike të Gjergj Fishtës.



Dr. Erarba Çiraku përshkroi rolin e Ahmet Zogut sipas dokumenteve diplomatike italiane.



Gjatë zhvillimit të kësaj konference, historianë, akademikë dhe studiues paraqitën hulumtimet shkencore mbi bazën e qasjeve të reja për rrugën drejt konsolidimit të regjimit republikan, organizmit të institucioneve, marrëdhënieve ndërkombëtare e më gjerë.

Punimet shkencore u përqendruan në zhvillimet historike, politike dhe sociale të kësaj faze të rëndësishme të historisë së shtetit shqiptar.

www.akad.gov.al

U organizua simpoziumi “Shkenca e hapur”

-Veprimtaria u zhvillua nga Komisioni i biologjisë, bujqësisë dhe veterinarisë dhe Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në bashkëpunim me departamentin e biologjisë dhe Qendrën e Florës dhe Faunës pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës-

Më 20 mars 2025, Komisioni i biologjisë, bujqësisë dhe veterinarisë dhe Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, organizuan në Fakultetin e Shkencave të Natyrës simpoziumin “Shkenca e hapur”.

Veprimtaria u zhvillua me pjesëmarrjen e kryetarit të Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike, pjesë e ASHSH-së, akad. Neki Frashëri, organizatorëve të kësaj veprimtarie: akad. Ilia Mikerezi, prof. Valbona Aliko, prof. Anila Mitre, prof. asoc. Ani Bajrami, prof. asoc. Blerina Vrenoz, si dhe kërkuesve të departamentit të biologjisë dhe Qendrës Kërkimore të Florës dhe Faunës (FSHN), pedagogëve, studentëve, mësuesve dhe nxënësve të disa shkollave të mesme të Tiranës.



Qëllimi i këtij simpoziumi ishte nxitja e mëtejshme e përgatitjes së brezave të

ardhshëm në përputhje me nevojat e kërkimit shkencor.

Akad. Ilia Mikerezi në fjalën e tij përshëndetëse i njohu të pranishmit me rekomandimet e UNESCO-s mbi shkencën e hapur, të cilat përbëjnë një standard ndërkombëtar në përcaktimin e instrumenteve kryesorë, me synimin kërkimi shkencor të jetë i pranueshëm për çdo njeri në të gjitha fushat, në të mirën jo vetëm të shkencëtarëve, por të të gjithë shoqërisë. Shkenca e hapur synon gjithashtu që produktet e diturisë së përfutur nga kërkimi shkencor të jenë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Një botë e hapur dhe e ndërthurur në një pafundësi mënyrash ka nevojë që përmes shkencës së hapur të arrijë të përballojë sfidat e ndërlikuara sociale, mjedisore dhe ekonomike për mbërritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm.

Përmes prezantimit të kërkimeve bashkëkohore dhe sfidave reale doli në pah rëndësia e biologjisë, zhvillimet aktuale në këtë shkencë dhe ndikimi i saj në jetën e përditshme, që nis që nga shëndeti mendor (neuroshkenca) deri tek ADN-ja edhe etika shkencore.



Prof. Anila Mitre paraqiti një studim për shëndetin mendor dhe ekuilibrin biologjik në ndërveprimin e mjedisit.

Prof. Valbona Aliko paraqiti një studim që zbulon fuqinë e muzikës në zhvillimin e trurit.

Prof. asoc. Ani Bajrami referoi një temë për ruajtjen dhe promovimin e diversitetit biokulturor vendas.

Prof. asoc. Blerina Vrenozi paraqiti studimin me temë “Merimangat helmuese: Miq apo armiq?”, sipas një vështrimi ekologjik mbi llojet helmuese të merimangave dhe

ndikimin e tyre në shëndetin publik.

Prof. asoc. Eliana Ibrahimimi paraqiti studimin “Nga algoritmet tek zbulimet: Si biologjia komputacionale dhe shkenca e hapur po transformojnë shkencat e jetës”.

Dr. Fundime Miri paraqiti studimin për praktikat e shkencës së qytetarit në monitorimin e biodiversitetit dhe rëndësinë e tyre në gjenerimin e të dhënave në shkallë të gjerë.

Dr. Ariol Rama paraqiti studimin për barcodimin gjenetik, lidhur me teknologjitë moderne për të zbuluar dhe mbrojtur biodiversitetin.

Dr. Odeta Vava paraqiti punimin “Etika dhe biologjia: Përballje me dilemat morale të shkencës moderne”, lidhur me përgjegjësitë e shkencës dhe shkencëtarëve në një botë në zhvillim.

Me studentët u diskutua për krijimin e urave të bashkëpunimit midis shkollës dhe universitetit duke e bërë shkencën më të arritshme, frymëzuese dhe pjesë të kulturës dhe edukimit për të gjithë.

Në fund u shpërndanë materialet informuese dhe u zhvilluan vizita në laboratorët shkencorë të departamentit të biologjisë për të parë nga afër punën kërkimore shkencore.

www.akad.gov.al

U zhvillua konferenca shkencore “Ndryshimet klimatike dhe uji: mbyllja e hendekut të paralajmërimit të hershëm së bashku”



Në datën 25 mars 2025 Njësia kërkimore e gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, organizoi konferencën shkencore “Ndryshimet klimatike dhe uji: mbyllja e hendekut të paralajmërimit të hershëm së bashku”.

Në këtë veprimtari morën pjesë inxhinierë dhe kërkues të fushës shqiptarë dhe të huaj, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe agjencive politikëbërëse dhe zbatuese të lidhura ngushtë me çështjen, staf akademik dhe përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë.

Drejtuesi i Njesisë kërkimore gjeoshkencat dhe gjeoinxhinieritë akad. Rrapo Ormëni hapi konferencën. Ai shprehu falënderimet për pjesëmarrjen dhe kontributin me punimet shkencore dhe vuri në dukje se kjo veprimtari zhvillohet në kuadër të 75-vjetorit të hyrjes në fuqi të konventës së themelimit dhe krijimit të Organizatës Botërore të Meteorologjisë (OBM). Kjo konferencë synon të përmirësojë paralajmërimet e hershme dhe menaxhimin e rreziqeve natyrore. Më tej, ai theksoi se konferenca është fryt i bashkëpunimit të grupit kërkimor shkencor “Toka dhe mjedisi” brenda Njesisë kërkimore të gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierisë (ASHSH) nën drejtimin dhe organizimin nga prof. asoc. Albana Hasimi, në bashkëpunim të ngushtë me njësi të tjera pranë Akademisë së Shkencave dhe institucioneve kërkimore shkencore në Shqipëri dhe në Kosovë.

Znj. Anila Shehi, drejtoresha e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore në fjalën e saj përshëndetëse theksoi se zhvillimi i kësaj konference na ofron mundësinë të diskutojmë mbi sfidat dhe zgjidhjet më të mira për menaxhimin e burimeve ujore, si dhe për përmbushjen e angazhimeve tona për zbatimin e kërkesave, si dhe të direktivave të BE-së për ujin. Një hap i rëndësishëm në këtë drejtim është ligji i ri “për burimet ujore”, i cili synon të vendosë baza më të forta për mbrojtjen dhe menaxhimin e këtyre burimeve.



Parandalimi dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike duhet të shoqërohen me investime të qëndrueshme, monitorim të vazhdueshëm dhe një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet institucioneve, Akademisë së Shkencave dhe aktorëve të tjerë. Roli i kërkimit shkencor është thelbësor në këtë proces, duke ndihmuar në hartimin e politikave të bazuara në të dhëna dhe forcimin e vendimmarrjes.

Në përfundim të fjalës së saj, drejtoresha e AMBU-së falënderoi Akademinë Shkencave për organizimin e kësaj veprimtarie dhe për kontributin e vazhdueshëm në avancimin e kërkimit shkencor mbi çështjet e ujit.

Në emër të kryesisë së Akademisë së Shkencave përshëndeti akad. Neki Frashëri, kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike. Ai theksoi se kjo konferencë do të kontribuojë në mbrojtjen më të mirë të mjedisit, sinimizimin e dukurive ekstreme të motit dhe përfshirjen e kërkimit shkencor në ecurinë e punës në fushën e emergjencave civile, duke përmirësuar sigurinë kombëtare.

Dr. Armend Agushi, drejtor i institutit Hidrometeorologjik të Kosovës, mbajti një

fjalë përshëndetëse, ku u shpreh për urgjencën e veprimit ndaj ndryshimeve klimatike dhe përgjegjësinë e përbashkët të institucioneve të Shqipërisë dhe Kosovës dhe organizmave të tjerë globalë për sigurinë dhe mirëqenien e shoqërisë. Forcimi i bashkëpunimit do të kontribuojë për një të ardhme më të qëndrueshme të burimeve ujore.

Në hapjen e kësaj konference u mbajtën edhe dy referate kryesore nga prof. dr. Petrit Zorba (Instituti i Gjeoshkencave, UPT) dhe Besim Aliu (Instituti Hidrometrologjik i Kosovës), përmes të cilave të pranishmit u njohën me përjasje të reja të të dhënave, ku krijohen lidhje mes politikës dhe klimës, me ndryshimet klimatike dhe diversifikimin e energjisë në Shqipëri, sfidat dhe mundësitë për një zhvillim të qëndrueshëm dhe nevojën për zhvillimin dhe përmirësimin e sistemeve të paralajmërimit të hershëm në Republikën e Kosovës.

Më pas vijuan katër sesionet e konferencës, gjatë të cilave u prezantuan 30 studime shkencore me interpretime dhe zgjidhje të reja për ndryshimet klimatike dhe ndikimin e tyre në rajonin e biosferës, menaxhimin e burimeve ujore, ndikimin e ndryshimeve klimatike në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, ndryshimet klimatike dhe ndikimet mbi zgjatjen e periudhës së vegjetacionit të bimësisë dhe nevojat për ujë etj.



Në këtë veprimtari u përfshinë 72 studiues dhe 22 institucione kërkimore universitare, administrative dhe biznesi nga Shqipëria e Kosova. Gjatë zhvillimit të sesioneve të kësaj konference prezantuan punime shkencore: prof. asoc. Albana Hasimi,

akad. Neki Frashëri, prof. dr. Sabri Avdullahi, dr. Gazmir Çela, prof. dr. Hajri Hasko, Roven Metoja, prof. Rigers Bakiu, dr. Anita Berberi, dr. Blerina Papajani, dr. Sonila Marku, dr. Astrit Shatro, dr. Adisa Daberdini, dr. Dhurata Ndreko, Daniel Pirushi, Bujana Xhindoli, dr. Entela Vako, prof. Aurel Nuro, prof. asoc. Bledar Myrtaj, dr. Majlinda Meçaj (Sina), Adrian Dhimitri, prof. asoc. Elsa Dindi, dr. Ariol Lule, Kristi Thodhorjani, Olgert Gjuzi, dr. Oltion Fejzollari.

www.akad.gov.al

Takimi i projektit “Slow Memory” Cost Action CA20105 në Tiranë

-Qendra e Studimit të Arteve, pjesë e Akademisë së Shkencave, mikpret për tri ditë rresht grupin qendror të punës të projektit “Slow Memory”, një projekt i rrjetit europian të kërkuesve Cost Action CA20105-



Sot më 26 mars 2025 u zhvillua dita e parë e takimit të grupit kryesor të projektit “Slow Memory”. Takimi i Tiranës është organizuar nga Qendra e Studimit të Arteve (ASHSH).

Ky projekt vë në qendër nevojën e rritjes ndërdisiplinore në të kuptuarin sesi shoqëritë përballen me të shkuarën e tyre, ndërsa përballen edhe me ndryshimet ekonomike e shoqërore që vijnë nga ngjarje të papritura dhe shndërrime të paimagjinueshme. E ardhmja e paqes, mirëqenies, politikës, punës dhe klimës varen nga mënyra se si i kujtojmë ndryshimet socio-kulturore dhe politike.

Dr. Anxhela Çikopano (organizatore e takimit të Tiranës, së bashku me prof. asoc. dr. Elsa Skënderin Rakiplarin, UT, dhe dr. Gilda Hoxhën, UMSH) mbajti fjalën e mirëseardhjes dhe bëri prezantimin e agjendës. Ajo vuri në dukje se praktikat transformuese të kujtesës si objekt studimi dhe si ndërhyrje kritike, ndahen midis arteve dhe shkencave, me qëllim që të zbulohen mënyrat sesi njerëzit përballen me proceset e ndryshimeve në shkallë të gjerë. Më tej, ajo theksoi se projekti përqendrohet në mënyrë unike në vëmendjen e studiuesve, politikëbërësve dhe profesionistëve kulturorë të rrugët alternative për të ndërtuar qëndrueshmëri përballë kulturës së shpejtë bashkëkohore.

Më pas u bë takimi i ekipit drejtues, ku foli drejtuesja e projektit dr. Jenny

Wustenbeg. Gjatë tri ditëve grupi do të organizojë një sërë vizitash në institucionet e kujtesës në Tiranë dhe do të njihet me historinë e artit shqiptar.



Pjesëmarrësit vijuan sipas programit me prezantimin e Tiranës dhe zhvilluan turneun e kujtesës mes pikave të rëndësishme të Tiranës, me një guidë nga prof. asoc. Andi Pinari, ku përfshihej edhe një vizitë në Muzeun e Gjetheve.

Më pas u zhvillua një panel me aktivistë të kujtesës: Vincent W.J. van Gerven Oei për projektin e lapidarëve, Erald Kapri për kujtesën e komunizmit me kujto.al, Rezarta Caushaj për objekte të shkatërruara të qytetit (Teatri Kombëtar, Stadiumi “Qemal Stafa”, etj.).

Përgjatë tri ditëve, të pranishmit në këtë veprimtari nga Shqipëria dhe vende të tjera të botës si Franca, Mbretëria e Bashkuar, Kroacia, Serbia, Danimarka etj., përmes diskutimeve mes shteteve dhe ndërdisiplinore, do të trajtojmë çështjet e ngutshme, krizat dhe përshpejtimin duke bashkuar fenomenet shumëvendëshe “pa ngjarje” dhe me lëvizje të ngadaltë, të cilat mund të studiohen më së miri duke ‘ngadalësuar’ metodat tona kërkimore, për të mundësuar ndërtimin e kapaciteteve, gjenerimin e dijes dhe aktivitetet me ndikim. Frymëzuar nga koncepti i ‘shkencës së ngadaltë’ (Stengers 2018), ata janë në kërkim të një alternative të kujtesës për të zhvilluar teori dhe metodologji që trajtojnë kujtesën e ngadaltë përmes bisedave ndërdisiplinore dhe angazhimit me aktorët e interesit. Për këtë projekt janë bërë takime të rregullta, si

virtualisht ashtu edhe personalisht.



Takimi i Tiranës do të vijojë deri më 28 mars 2025.

www.akad.gov.al

U zhvillua konferenca "Viti arkeologjik 2024"

Më 27 mars 2025 Instituti i Arkeologjisë, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, zhvilloi konferencën "Viti arkeologjik 2024".



Konferenca u drejtua nga kryetari i Institutit të arkeologjisë, akad. Adem Bunguri; kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike akad. asoc. Gëzim Hoxha dhe kryetari i Komisionit të arkeologjisë prof. dr. Neritan Ceka.

Në këtë konferencë u paraqitën 26 punime shkencore nga kërkues dhe studiues të tri departamenteve të Institutit Arkeologjik: Departamenti i prehistorisë; Departamenti i antikitetit dhe Departamenti i antikitetit të vonë dhe i mesjetës.

Prezantimet paraqitën të reja të shkencës kombëtare dhe ndërkombëtare të arkeologjisë, lidhur me zbulimet gjatë vitit 2024.

Seanca e parë nisi me prezantimin e rezultateve të projektit shqiptaro-zviceran LIN 3, 2024, të cilat e rendisin si vendbanimin më të vjetër palafit në Europë. Studimi është përgatitur nga Adrian Anastasi, Ilir Gjipali, Albert Hafner, M. Hinz, M. Brunner, K. Anastasi. Zbulimet në këtë sit arkeologjik treguan që vendbanimet palafite në "Lin-3"

ishin më të vjetrat në Europë, 6000 BC dhe konsiderohet si vendbanimi më i vjetër liqenor të këtij lloji në Europë. Më tej, E. Andoni, J. Anvari, P. Willett prezantuan rezultatet e kërkimeve arkeologjike për Neolitin në fushën e Korçës. E. Andoni, paraqiti gjithashtu edhe një studim të sondazheve arkeologjike në vendbanimin e Neolitit të hershëm në Pogradec.

Gjatë kësaj seance u prezantuan edhe dinamikat e vendbanimit gjatë periudhës së Hekurit në pellgun e Korçës: “Kalaja” e Barçit (misioni shqiptaro-francez i pellgut të Korçës - 2024) nga R. Kurti, A. Gardesein, me kontributin e E. Glass, A. Bici, U.Tota. Nëpërmjet këtij studimi u paraqitën gjurmët arkitekturore të periudhave të ndryshme, gjatë periudhës së hekurit dhe asaj qytetare ilire, rreth 2800 vjet më parë.



E. Kujtila paraqiti rezultatet e sondazheve arkeologjike në fortifikimin prehistorik të Orenjës (Librazhd, 2024), ku janë përftuar të dhëna stratigrafiko-kulturore që e mbështesin zhvillimin e jetës në këtë vendbanim në 3 faza kronologjike të emërtuara Orenjë I-II-III, përkatësisht të lidhura me Bronzin e Hershëm, Bronzin e Vonë dhe periudhën e vonë antike.

Në fund të seancës A. Anastasi prezantoi hartën arkeologjike nënujore të bregdetit shqiptar 2024. Më pas u bënë pyetje e diskutime lidhur me saktësimin e periudhave të zbulimeve më të fundit në arkeologji.

Në seancën e dytë u paraqitën rezultatet e studimeve të Departamentit të antikitetit.

Orgita Ceka paraqiti rezultatet e gërmimeve në monumentet e tarracës perëndimore të agorasë së Bylisit, si dhe rezultatet e fushatës arkeologjike të vitit 2024 në Gurëzëzë.

B. Muka e F. Quantin prezantuan studimin “Apolonia e Ilirisë”.

Jamarbër Buzo prezantoi rezultatet e studimit për nekropolin verilindor të Amantias – Sektori 7.

Në këtë seancë prezantuan studimet e tyre S. Veseli, E. Pitt, E. Shehi, S. C. Fioriello për arkeologjinë e peizazhit në zonën Memaliaj-Tepelenë; S. Veseli, R. Perna për kërkimet në Antigone gjatë vitit 2024, që shtrihen përgjatë luginës së Drinosit. Rezultate të rëndësishme të zbulimeve gjatë vitit 2024, përkatësisht në Foinike dhe Butrint, në Dobër, në Çukën e Ajtoit u prezantuan nga B. Muka, G. Lepore, E. Giorgi, M. Melfi, E. Metalla, J. Bogdani.

Pas pyetjeve dhe diskutimeve, nisi seanca e tretë, në të cilën u prezantuan zbulimet e periudhës së antikitetit të vonë dhe mesjetës.

Në këtë seancë paraqitën punime shkencore nga Brikena Shkodra, Ulsi Tota, M. Nushi, C. Metkola, B. Forsén, Elio. Hobdari, N. Molla, R.Hodges, E. Metalla, S. Antonelli, P. Pushimaj, E. Nikolli, M. Meshini. Ata trajtuan zbulimet e bazilikës paleokristiane së Elbasanit , në Manastirin e Ballshit 2024, në Kishën e Shën Mërisë, në Kodrën e Muzhilës - Drisht 2024, në prapatokën e Durrësit”, në Butrint, në territorin e Sappës etj.

Ekspeditat dhe gërmimet arkeologjike të zhvilluara gjatë vitit 2024 u vlerësuan si shumë të suksesshme për sasinë dhe shumëllojshmërinë e materialit arkeologjik, i cili do të shërbejë si objekt studimi në vazhdim nga specialistët e projekteve të Institutit Aarkeologjik (ASHSH).

Këto ekspedita janë zhvilluar në përputhje me misionin e Akademisë së Shkencave për realizimin e projekteve me perspektivë shumëvjeçare si Lini, Butrinti, Finiqi, Bylisi, Apolonia etj.

Vizitë zyrtare e delegacionit kinez të Aleancës së Organizatave Ndërkombëtare të Shkencës (ANSO) në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë

Më 28 mars 2025 në ambientet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH) u zhvillua një takim zyrtar me delegacionin kinez të Aleancës së Organizatave Ndërkombëtare të Shkencës (ANSO).

Delegacioni kinez u prit nga përfaqësues të ASHSH-së, kryesuar nga akad. Anila Hoda, sekretare shkencore e ASHSH-së; akad. Genc Sulçebe, drejtues i Qendrës Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës; akad. Ilia Mikerezi bashkëkryetar i Komisionit të biologjisë, bujqësisë dhe veterinarisë; prof. dr. Vjollca Ibro, anëtare e Komisionit të biologjisë, bujqësisë dhe veterinarisë; prof. asoc. Valbona Kolaneci, anëtare e Njesisë së pasurive ujore; prof. asoc. Gjon Boriçi, studiues, Instituti i Historisë dhe prof. asoc. Elda Zotaj, drejtuese e zyrës së marrëdhënieve me jashtë dhe publikun.



Delegacioni kinez përbëhej nga 7 anëtarë, prof. Bai Chunli, president themelues i ANSO-s; akademik i Akademisë Kineze të Shkencave (CAS); z. Jia Bo, zëvendës drejtor ekzekutiv, sekretariati i ANSO-s; prof. Ye Yang, zëvendës drejtor i përgjithshëm, Instituti i Mjekësisë Materiale, Shanghai, Akademia e Shkencave e Kinës; dr. Ning Bolun, drejtor i Divizionit të Çështjeve Europiane, Zyra e Bashkëpunimit Ndërkombëtar, Akademia e Shkencave e Kinës; z. Li Zhangwei, sekretar i presidentit Bai Chunli, Departamenti i Administratës së Përgjithshme, Akademia e Shkencave e Kinës; dr. Li Qian, Oficer i Programit, sekretariati i ANSO-s; z. Xu Shengjie, kryetar dhe

president i Puyuan Holdings Group. Prof. dr. Sokol Abazi ishte gjithashtu pjesëmarrës në takim dhe shoqëronte delegacionin kinez.

Takimi kishte për qëllim diskutimin mbi prioritetet dhe iniciativat kërkimore të të dyja institucioneve, si dhe mundësitë për të krijuar ura bashkëpunimi në fusha të ndryshme të shkencës, përfshirë inovacionin dhe teknologjinë. Po ashtu, u diskutua rreth mundësive të bashkëpunimit në mobilitetin e stafit kërkimor, rinovimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave të Kinës, si dhe iniciativat për projekt-ide në fushat shkencore.

Në fjalën e saj akad. Hoda, në emër të kryesisë, u uroi mirëseardhjen dhe shprehu falënderimet për interesin e shprehur për të vizituar Akademinë e Shkencave. Ajo tha se ky është një takim shumë i rëndësishëm dhe një mundësi e madhe për të diskutuar bashkërisht potencialet që ekzistojnë mes dy institucioneve, si dhe për ta çuar në një nivel tjetër bashkëpunimin mes tyre. Ajo i njohu të pranishmit me përbërjen e delegacionit të ASHSH-së dhe fushat respektive të kërkimit shkencor që ata drejtojnë.



Në fjalën e tij, kreu i delegacioni kinez prof. Bai Chunli u shpreh se ndihej i nderuar, që në këtë vizitë të parë në vendin tonë ka mundësinë të njohë dhe diskutojë me përfaqësues të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për të gjetur pika të përbashkëta në zhvillimin e bashkëpunimit shkencor mes dy palëve. Ai bëri një prezantim të delegacionit që kryesonte dhe u ndal në paraqitjen e një panorame të institucionit që ai përfaqëson. Ai tha se ANSO është një organizatë ndërkombëtare shkencore jofitimprurëse, e themeluar në vitin 2018 nga Akademia Kineze e Shkencave

dhe 36 institucione të tjera globale dhe aktualisht ka 78 anëtarë. Kjo organizatë është krijuar për të promovuar zhvillimin e përbashkët dhe të qëndrueshëm, duke ndihmuar avancimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (SDG), përmes bashkëpunimit ndërkombëtar në fushat e shkencës, teknologjisë, inovacionit dhe ndërtimit të kapaciteteve (STIC). Fokusi i saj është në adresimin e sfidave shkencore globale dhe rajonale, duke mbështetur ndërtimin e kapaciteteve shkencore të Jugut Global përmes partneriteteve me vendet dhe institucionet anëtare. Qëllimi i ANSO-s është të krijojë një platformë bashkëpunimi të hapur dhe gjithëpërfshirëse, që nxit komunikim dhe bashkëpunim shkencor të thelluar dhe ndihmon zhvillimin e rajoneve, të një brezi, një rruge, duke kontribuar në krijimin e një komuniteti global me një të ardhme të përbashkët.



Në vijim të takimit akad. Hoda bëri gjithashtu një prezantim të misionit e strukturës së Akademisë së Shkencave. Ajo i njohu me reformën e zhvilluar vitet e fundit, që u kurorëzua me bashkimin e instituteve pranë kësaj akademie dhe ngritjen e qendrave dhe njësive të përhershme e të përkohshme, si dhe ngritjen e Akademisë së të Rinjve. Gjithashtu u theksua ngritja e komisioneve në përbërjen e të cilave janë figura të

spikatura të shkencës si dhe stafe akademike të institucioneve të arsimit të lartë në vend. Më tej bëri një prezantim të lidhjeve që ka ASHSH-ja me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare. ASHSH-ja është anëtare e institucioneve prestigjioze si ALLEA (All European Academies), ISC (International Science Council), etj.

Sekretarja shkencore e ASHSH-së foli edhe për realizimin e tri projekteve të mëdha: Fjalori i madh i gjuhës shqipe, Enciklopedia shqiptare dhe Historia e shqiptarëve. Ajo e prezantoi delegacionin kinez me rolin dhe funksionin e qendrave dhe njësive kërkimore pranë Akademisë së Shkencave dhe e vuri theksin te puna kërkimore shkencore e zhvilluar nga Qendra e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës dhe Qendra Nano Balkan. Shkencëtarët e këtyre qendrave kanë dhënë kontribute në rrjetin e shkencëtarëve europianë me vendosjen e bashkëpunimit me qendra homologe të kërkimit shkencor në rajon, në Europë e më gjerë.

Të dyja delegacionet diskutuan për prioritetet dhe aktivitetet kërkimore të tyre, duke u ndalur në mundësitë për krijimin e partneriteteve të reja. Po ashtu, u theksua rëndësia e bashkëpunimit në fushat që ndërlidhen me teknologjinë, inovacionin dhe zhvillimin e kapaciteteve shkencore.

Ky takim shënon një hap të rëndësishëm drejt zgjerimit të bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe fuqizimit të lidhjeve mes dy institucioneve në fushën e kërkimit dhe shkencës, dhe krijon mundësinë për të forcuar më tej marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Kinës.

www.akad.gov.al

Njësia NanoAlb, pjesë e Akademisë së Shkencave, zhvilloi veprimtarinë “Ditë të hapura për kërkimin në grupet NanoBALKAN”



Në datat 10 dhe 11 mars 2025, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, u zhvilluan një sërë aktivitetesh për kërkimin në grupet NanoBALKAN.

Veprimtaria u organizua nga Njësia NanoAlb, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe me mbështetjen e SUSNANO-s dhe Universitetit të Tiranës.

Kjo veprimtari u drejtua nga prof. dr. Majlinda Vasjari e prof. dr. Kledi Xhaxhiu me mbështetjen e anëtarëve të Njesisë NanoAlb (ASHSH).

Morën pjesë studentë të masterit shkencor në nanoteknologji në WBU, si dhe nxënës të disa shkollave të mesme.

Takimi u mbajt me synimin që pjesëmarrësit në këtë veprimtari të njihen me infrastrukturën shkencore të grupeve NanoBALKAN për vendosjen e bashkëpunimeve në të ardhmen, me laboratorët, objektet e tyre dhe pajisjet që përdoren për tema dhe projekte të ndryshme kërkimore lidhur me nanoteknologjinë, si dhe zhvillimin e diskutimeve me studentët e masterit e të doktoraturës lidhur me nanotoksicitetin dhe biomarkerërit e efektit.

Gjatë takimit dyditor u ligjëruan studimet e 9 praktikave laboratorike me temë: “Grupi i nanomaterialeve në mbrojtjen e mjedisit” nga prof. asoc. Sonila Vitos; “Sensorë dhe biosensorë që përdorin nanomateriale” nga prof. dr. Majlinda Vasjari; “Grupi Nano, mikromateriale dhe sensorë për aplikime teknike dhe mjedisore” nga prof. dr.

Kledi Xhaxhiu; “Grupi i materialeve të ndërtimit të qëndrueshëm, nanostrukturuar” nga prof. dr. Arjan Korpa; “Grupi i kërkimit mjedisor” nga prof. dr. Sonila Duka; “Grupi kërkimor në bioteknologji molekulare” nga prof. dr. Ariola Bacu; “Grupi i bioteknologjisë dhe fiziologjisë bimore in vitro” nga prof. dr. Valbona Sota; “Nanotoksiciteti dhe biomarkërit e efektit” nga prof. dr. Valbona Aliko; “Biomarkerët në sëmundjet e rralla gjenetike - grupi kërkimor” nga prof. dr. Merita Xhetani.

Gjatë kësaj veprimtarie u theksua nevoja për të pasur më shumë mbështetje për të forcuar kërkimin dhe për të ndërtuar një qendër kërkimore të nivelit të lartë NanoBALKAN dhe u evidentua kërkimi shkencor në nivel të lartë i grupeve NanoBALKAN bazuar edhe në bashkëpunimet midis tyre në kuadër të projekteve kombëtare dhe europiane.

Jubile akademik

Akademia e Shkencave uron akademikun e asociuar Stefan Çapaliku në ditën e tij të lindjes



Kryesia e Akademisë së Shkencave uron në ditën e tij të lindjes shkrimtarin, dramaturgun dhe studiuesin akad. asoc. Stefan Çapaliku:

Gëzuar ditëlindjen. Jetë të gjatë dhe vepra të arrira, miku dhe kolegu ynë i dashur!

Stefan Çapaliku ka lindur në qytetin e Shkodrës më 10 mars 1965.

Ai është drejtor i Qendrës së Studimit të Arteve, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Për të ditur më shumë rreth veprës dhe krijimtarisë së tij, ndiqni linkun në faqen zyrtare të Akademisë së Shkencave:

<https://akad.gov.al/drejtore-qsa/>

www.akad.gov.al

Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Kryesia e saj i urojnë kirurgut të njohur akademik Besim Elezit: Gëzuar 90 vjetorin e lindjes!



-Përmes këtij urimi Kryesia e ASHSH-së, dhe Asambleja e ASHSH-së i shprehin mirënjohje të thellë këtij personaliteti të shquar të shkencës dhe mjekësisë me njohje europiane

Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Kryesia e saj i urojnë akademik Besim Elezit, profesorit të shquar, kirurgut të njohur që ka zgjatur qindra e qindra jetë njerëzore:

Gëzuar 90-vjetorin e lindjes! Edhe 100, i dashur akademik, mjek dhe mik i çmuar!

Akad. Besim Elezi gjatë karrierës së tij ka përmbledhur në një kolanë të gjerë veprash shkencore eksperiencat shumëvjeçare pedagogjike, kërkimet shkencore dhe përvojat e pasura klinike. Bëhet fjalë për mbi 76-publikime si "Ekinokokoza e mushkërive. Rezultatet e larta të mjekimit", "Kirurgjia: principe dhe praktika", 2 vëllime, 2000 (e të tjera renditur me poshtë në biografinë e akad. Besim Elezit.)

Akad. Elezi është kryetar i Shoqatës së Kirurgëve të Shqipërisë, anëtar i Komitetit Permanent të Eurokirurgjisë dhe anëtar i Kolegjit Ndërkombëtar të Kirurgëve; autor i shumë botimeve monografike dhe i mbi 100 artikujve shkencorë në gjuhën shqipe e gjuhë të huaja. Ai është simbol i dijetarit që kurrë nuk e ka ndarë katedrën nga shërbimi.

Për vite me radhë ai ka kontribuar në ngritjen e shërbimit të kirurgjisë në Shqipëri. I specializuar për anesteziologji në Danimarkë, për endokrinokirurgji në Rumani, për kirurgji të përgjithshme në Kinë, për kirurgji ezofagale në Francë, ndërsa ka bërë edhe specializime të tjera në Itali e në Austri, akad. Besim Elezi mban disa tituj dhe grada "Doktor i shkencave mjekësore", gradën "Docent" e "Profesor", titujt "Akademik i asociuar" e "Akademik".

Akademiku e kirurgu i shquar, gjithë karrierën e tij e zhvilloi në dyert e spitalit në qendrën spitalore "Nënë Tereza", ku ka dhënë një kontribut të madh në fushën e mjekësisë.

Jeta dhe karriera e akademik Besim Elezit

Akademik Besim Elezi lindi më 20 mars të vitit 1935, në Ftterrë të Sarandës, ndërsa shkollimin e kreu në Gjirokastrë. Studimet e larta i kreu në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, nga viti 1952-1957, ku u diplomua si mjek. Në vitin 2008 u shpall "Akademik i asociuar", dhe në 2010-n "Akademik". Ai është anëtar i ASHSH-së, Seksioni Shkencat Natyrore dhe Teknike. Di gjuhët anglisht, frëngjisht, italisht, rusisht.

Kualifikimet

Specializim në kirurgji të përgjithshme, titulli "Kirug", 1960.

Kandidat i shkencave mjekësore, 1965.

Specializim në anesteziologji në International Anaesthesiology Center, Kopenhagen, Danimarkë, 1966-1967.

Specializim në endokrinokirurgji në Institutin Parhon, Bukuresht, Rumani, 1967.

Docent pranë Universitetit të Tiranës, fakulteti i mjekësisë, katedra e kirurgjisë, 1970.

Specializim në kirurgji të përgjithshme, Pekin, Kinë, 1973.

Specializim në kirugji ezofagale në Hôpital Beaujon, Paris, Francë, 1985.

Titulli "Doktor i shkencave mjekësore", 1987.

Titulli "Profesor", 1989.
Specializim në kirurgji digjестive, Padova, Itali, 1995.
Specializim në endoskopinë digjестive, Melburn, Australi, 1998.
Titulli "Akademik i Asociuar", dhënë nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2008.
Titulli "Akademik", dhënë nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2010.
Urdhri "Naim Frashëri", i klasit I dhe III.
Urdhri "Personalitet i Shquar i Shkencës dhe Teknologjisë".
Poste drejtuese
Shef i klinikës së kirurgjisë nr. 3, 1976.
Shef i katedrës së kirurgjisë, Universiteti i Tiranës, fakulteti i mjekësisë, 1986.
Shef i departamentit të kirurgjisë, Universiteti i Tiranës, fakulteti i mjekësisë, 1992.
Shef i shërbimit të kirurgjisë, Durrës, 2004.
Presidenti i parë i Shoqatës Shqiptare të Kirurgjisë së Përgjithshme, 1999.
Felloë of the International College of Surgeons, 1996.
Bashkëredaktues i Bordit Editorial të "International Surgery", revista zyrtare e International College of Surgeons, 1996.
Anëtar i Permanent Committee of EuroSurgery.
Drejtimit i projekteve shkencore
Drejtues i dy projekteve të sponsorizuara nga OBSH:
"Infeksionet post-operatore të plagëve dhe masat për uljen e incidencës"
"Racionalizimi i përdorimit të transfuzionit të gjakut."
Drejtues shkencor i pesë disertacioneve.
Aplikime klinike
Aplikimi i rreth 20 ndërhyrjeve dhe metodave diagnostike të reja në praktikën klinike.

Publikime

Midis 76 publikimeve që përfshijnë libra, monografi, artikuj dhe referate, veçohen tre më të rëndësishmit:

1. Teksti "Kirurgjia: principe dhe praktika", 2 vëllime, 2000 f., shtëpia botuese "ILAR",

Tiranë, 2012. Si autor kryesor dhe kryeredaktor ka ftuar 47 specialistë vendas dhe të huaj, të shquar në fushat e tyre për të bashkëpunuar në këtë botim. Ky libër i bazuar në tekste të mirënjohura ndërkombëtare plotësoi një boshllëk në literaturën mjekësore shqiptare. Në të përmbledhet eksperiencia shumëvjeçare pedagogjike, kërkimet shkencore dhe përvojat e pasura klinike, të ilustruara me një shumëllojshmëri

fotografish nga fondi personal.

Kapituj si: historia e kirurgjisë shqiptare, kirurgjia e ezofagut dhe endokrinokirurgjia përfshijnë një sërë kontributesh origjinale e inovative.

2. "Hidatidoza parësore dhe dytësore në Shqipëri", shtëpia botuese universitare, Tiranë, 1992.

Ky studim jep një tablo të plotë të epidemiologjisë së kësaj sëmundjeje në Shqipëri, duke sjellë udhëzime praktike për parandalimin e saj. Në hidatidozën dytësore demonstrohet një pajisje teknike origjinale që shërben për parandalimin e përsëritjes së sëmundjes.

Studimet në fushën e hidatologjisë përbëjnë një kontribut të veçantë dhe janë mirëpritur në shumë konferenca e takime ndërkombëtare.

3. "Ekinokokoza e mushkërive. Rezultatet e larta të mjekimit", Shtëpia Botuese Universitare, Tiranë, 1974. Kjo monografi është unike në llojin e saj ndër artikujt e shkruar në literaturë botërore të asaj kohe. Nga ky punim dalin konkluzione praktike për racionalizimin e trajtimit të ekinokokozës.

www.akad.gov.al

Botime të reja

Botimet më të fundit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Tri vepra të reja, dy nga fusha e historisë së artit dhe një nga mjekësia, i shtohen kolanës së botimeve të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.


1. "Veshjet tradicionale në artin pamor shqiptar"

Autor: Abaz Hado

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2024.

291 faqe

ISBN 9789928809469



Vepra synon të pasurojë me informacionin e nevojshëm njohjen, ndikimin, bashkëpunimin dhe pasurimin e artit pamor me bukurinë, larminë dhe pasurinë e veshjes tradicionale. Në të do të gjeni të përmbledhur në mënyrë selektive veprat kryesore të artit shqiptar, prej mbi 150 vjetësh, por dhe më parë, ku qartësisht është i dukshëm ndikimi nga vlerat, fryma dhe larmia e artit popullor.

Sipas recensentes së këtij botimi, Afërdita Onuzi, ky studim afron analizën konkrete, duke sjellë konkluzione mbi atë produkt tashmë të krijuar, si formë origjinale e artit pamor, përmes së cilës ka shprehur një unitet etnik kombëtar. "Studimi i

mundëson kujtudo të njihet me artin popullor dhe me ndikimin e tij në artin e kultivuar shqiptar. Sepse ky art, që në krijimet e para, u formua, u modelua dhe u zhvillua përmes një platforme filozofike, estetike dhe metodike e lidhur me artin popullor. Këto studime janë mirëfilli punë kërkimore, që tentojnë të sjellin një kontribut real, mbi ndikimin, lidhjen, shfrytëzimin e etnografisë, folklorit mitologjik në pikturën, skulpturën, grafikën, vizatimin shqiptar. Nëse dollmaja, xhubleta, tirqet, herkat e bardhë të burrave në Kosovë, poturet, fustanellat, dollamet etj. janë të bukura nga ana estetike me pasuri të madhe ngjyrash, kanë ndikimin e tyre në artin pamor.”


2. “Piktura e kishave e shekujve V-XV në Shqipëri”

Autore: Dhorka Dhamo

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2024

295 faqe

ISBN 9789928809438



“Piktura e kishave e shekujve V-XV në Shqipëri” vjen si një botim special për pikturën mesjetare shqiptare, në të cilin lexuesi do të informohet për monumentet kryesore të pikturës që mbushin muret e kishave e manastireve në periudhën e

sipërpërmendur. Ky botim u vlen studiuesve, historianëve të artit, bizantinologëve anembanë botës, studentëve e promovuesve të turizmit kulturor në Shqipëri.

Dy recensentët e botimit, Aleksandër Meksi dhe Pirro Thomo, kanë vlerësuar veprën për trajtimin që i bën artit kishtar në të gjitha shfaqjet e tij gjinore e tipologjike, në mozaikë, miniatura, ikona etj. Sipas tyre, analizat për monumente të veçanta shoqërohen me një material të bollshëm ilustrativ dhe nga një bibliografi e pasur, që i bën bindëse përfundimet e arritura. Informacioni i shumanshëm që përftohet, si dhe gjuha e kuptueshme e përdorur, bën që monografia të jetë e vlefshme jo vetëm për specialistët e fushës, por dhe për opinionin e gjerë shoqëror të interesuar për njohjen e pasurisë kulturore të vendit. Gjithashtu, ajo mund të shërbejë edhe për hartimin e teksteve mësimore për studentët e degëve përkatëse.

3. “Protokollet e trajtimit sistematik të kancerit”

Autorë: Bledi Kreka & Manika Kreka Face

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2025

446 faqe

ISBN 9789928809605



“Protokollet e trajtimit sistemik të kancerit”, konceptuar në kapituj lehtësisht të kuptueshëm për mjekët dhe stafet mjekësore, renditur sipas peshës specifike të çdo patologjie, trajton 17 neoplazitë më të shpeshta në adultët: kanceri i gjirit, i pulmonit, i traktit digjestiv, i gjakut, i aparatit urogenital, të lëkurës.

Ky manual, sipas recensentes dr. Anila Kristo, është një instrument i mirë pune për onkologët mjekësorë dhe personelin infermior në spitalin onkologjik, onkopediatri dhe në qendrat e trajtimit me kimioterapi në spitalet rajonale. “Në të përshkruhen qartësisht skemat e aplikimit të kimioterapisë, kohëzgjatja e trajtimit dhe radha e infuzioneve. Në mënyrë të qartë e koncize përshkruhen efektet anësore kryesore dhe menaxhimi i tyre kryesisht nëpërmjet modifikimit të dozave në varësi të shkallëve të ndryshme të toksicitetit. Përveç të dhënave praktike të aplikimit të çdo skeme, autorët ndërpusin edhe indikacionet terapeutike kryesore, pra skenarin në të cilin çdo skemë do të mund të aplikohet” - vlerëson ajo.

Ndërkohë, recensentja tjetër, prof. dr. Anila Godo, thekson se vlera e madhe e këtij libri është që synon dhe realizon më së miri një skemë mjaft të gjerë e të thellë, me tërësinë e detajuar të tërë elementëve që duhen konsideruar e përballuar në menaxhimin e kancerëve më të shpeshtë tek adultët. “Ky botim përbën një vlerë të çmuar për onkologjinë shqiptare, pasi konkretisht çdo onkolog, por edhe çdo specialist tjetër që gjendet i përfshirë në trajtimin e kancerit, do të ndihmohet me një udhërrëfyes për menaxhimin e pothuaj tërë neoplazive të adultit. Ky udhërrëfyes është tepër i plotë, i kohës, i gjerë e i thellë, tepër i hollësishëm, duke ofruar sjelljen e përshtatshme të klinikistit, në menaxhimin e tërësisë së problemeve të shumta me të cilat të përball trajtimi e ndjekja e një pacienti me kancer” -vlerëson ajo.

Për botimet e ASHSH-së shih linkun: <https://akad.gov.al/viti-2024/>

Librat i gjeni pranë godinës së Librit Akademik në Akademinë e Shkencave
www.akad.gov.al